

PRISHTINË, NËNTOR 2021

TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA NË UNIVERSITETET PUBLIKE TË KOSOVËS

3

Menaxhimi i financave



TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA NË UNIVERSITETET PUBLIKE TË KOSOVËS

Menaxhimi i financave

Publikues:

ORCA – Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim

www.orca-ks.org

info@orca-ks.org

Henrik Bariç, Nr. 6

Prishtina, 10000, Kosova

Autorë:

Liridona Ademaj

Skord Retkoceri

Hulumtues:

Skord Retkoceri

Adea Kondirolli

Liridona Ademaj

Design:

Envinion



“Ati ynë që je në qiell, jepna fuqinë ta mbajmë
gojën mbyllur kur s’kemi gjë për të thënë.
Falna durimin të thellojmë një punë përpara
se të shkruajmë mbi të! Frymëzona me një
ndjenjë të mprehtë të drejtësisë që të flasim jo
vetëm me paanësi, por edhe të sillemi ashtu!
Shpëtona nga grackat e gramatikës, nga
shtrembërimet e gjuhës dhe nga lajthitjet e
shtypit. Ashtu qoftë!”

[Faik Konica]

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje.....	10
Gjetjet kryesore.....	12
Universiteti i Prishtinës	22
Analiza e shpenzimeve	23
Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Prishtinës.....	25
Analiza e të dhënave nga deklaratimet e pasurisë	26
Universiteti i Prizrenit	34
Analiza e shpenzimeve	35
Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Prizrenit.....	37
Analiza e të dhënave nga deklaratimet e pasurisë	38
Universiteti i Pejës.....	44
Analiza e shpenzimeve	45
Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Pejës	47
Analiza e të dhënave nga deklaratimet e pasurisë	48
Universiteti i Gjakovës	54
Analiza e shpenzimeve	55
Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Gjakovës.....	57
Analiza e të dhënave nga deklaratimet e pasurisë	58
Universiteti i Mitrovicës.....	64
Analiza e shpenzimeve	65

Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Mitrovicës	66
Analiza e të dhënave nga deklaratimet e pasurisë	68
Universiteti i Gjilanit	74
Analiza e shpenzimeve	75
Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Gjilanit	77
Analiza e të dhënave nga deklaratimet e pasurisë	78
Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj	84
Analiza e shpenzimeve	85
Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj	86
Analiza e të dhënave nga deklaratimet e pasurisë	87
Metodologjia	92
ANEKSI NR.1	93
Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Prishtinës sipas deklaratimeve të pasurisë	
ANEKSI NR.2	96
Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Prizrenit	
ANEKSI NR.3	97
Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Pejës	
ANEKSI NR.4	98
Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Gjakovës	
ANEKSI NR.5	99
Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Mitrovicës	
ANEKSI NR.6	100
Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Gjilanit	
ANEKSI NR.7	101
Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj	

LISTË E SHKURTESAVE

- **MASHTI** – Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë, dhe Inovacionit
- **PSAK** – Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë
- **UP** – Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”
- **UHZ** – Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka”
- **UPZ** – Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”
- **UGJFA** – Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani”
- **UMIB** – Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”
- **UKZ** – Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka”
- **USHAF** – Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj
- **AKK** – Agjencia kundër Korrupsionit
- **ASK** – Agjencia e Statistikave të Kosovës
- **ZKA** – Zyra Kombëtare e Auditimit
- **KEC** – Qendra për Arsim e Kosovës
- **KEEN** – Rrjeti i Kosovës për arsim dhe punësim
- **ORCA** – Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim

HYRJE

Burimi kryesor prej nga financohen universitetet publike në vendin tonë, vazhdon të mbetet buxheti i Republikës së Kosovës. Ndërkaq transparenca dhe llogaridhënia e këtyre institucioneve është më se e domosdoshme, për t'u treguar se si po ndahen këto mjete dhe cilat janë prioritetet e këtyre universiteteve sa i përket shpenzimit të fondeve publike.

Kjo është hera e tretë që ORCA hulumton, analizon dhe krahason shpenzimet e shtatë universiteteve publike, me theks të veçantë tek stafi akademik menaxherial por edhe tek investimet apo financimet relevante brenda universiteteve.

Të dhënat që gjenden në këtë raport, janë marrë nga raportet vjetore të buxhetit të universiteteve publike, komunikimi përmes adresës elektronike me universitete, raporti vjetor financiar i buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2020¹, raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) për vitin 2020², raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Universitetit të Prishtinës për vitin 2020³, deklarinimet e pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsion, si dhe nga Agjencia e Kosovës për Statistika.

Pjesë e këtij hulumtimi janë stafi akademik i universiteteve publike me këto pozita menaxheriale: anëtar i Këshillit Drejtues, rektor, prorektor, dekan dhe prodekan.

Qëllimi i këtij hulumtimi është që të gjejë dhe të sjellë informata rreth pagave bazë me të cilat paguhen këta zyrtarë sipas rregulloreve për të ardhura personale dhe mëditjeve apo shtesave që marrin, si dhe menaxhimin e financave të tjera brenda universiteteve.

¹ Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, linku: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/4CEFBA4C-4397-4901-AB93-2AA37F43A9F7.pdf>

² Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për vitin 2020, linku: file:///C:/Users/DELL/Desktop/Raporti%20i%20shpenzimeve%20dhe%20transparenc-es%203/RaportiAuditimit_MASHTI_2020.pdf

³ Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Universitetit të Prishtinës për vitin 2020, linku: https://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2021/07/RaportiAuditimit_UP_2020_Shqip.pdf

Krahasuar me raportin e vitit 2018⁴, atë për vitin 2019⁵, rezulton se vazhdon të ketë përmirësime të dukshme sa i përket shumës së shtesave të cilat i marrin stafi akademik menaxherial.

Numri i përgjithshëm i personelit akademik të rregullt në universitete publike për vitin 2020, është 1 mijë e 358 (726 *gra dhe* 632 *burra*), ndërsa i të angazhuarve është 703 (319 *gra dhe* 384 *burra*)⁶, ndërkohë që në vitin 2019 ishte 1 mijë e 275 (685 *gra dhe* 590 *burra*) pra janë shtuar 83, kurse i të angazhuarve, ishte 700 (356 *gra dhe* 344 *burra*) pra janë shtuar 3 gjatë vitit 2020.

Numri i përgjithshëm i studentëve në nivelin Bachelor nga të gjitha universitetet publike, është 46 mijë e 27 studentë, derisa në vitin 2019 ishin 50 mijë e 91 studentë, pra 4 mijë e 64 studentë më pak në vitin 2020. Ndërkaq numri i studentëve të diplomuar (2019/2020), është 5 mijë e 939, derisa numri i studentëve të diplomuar (2018/2019), ishte 7 mijë e 282, pra në vitin 2020 ishin 1 mijë e 343 më pak.

Numri i përgjithshëm i studentëve në nivelin Master është 7 mijë e 925 derisa në vitin 2019 ishte 8 mijë e 184. Ndërkohë që numri i studentëve të diplomuar në këtë nivel (2019/2020), është 1 mijë e 650 derisa numri i studentëve të diplomuar në këtë nivel (2018/2019), ishte 2 mijë e 274.

Raporti student-mësimdhënës në nivel të universiteteve publike për vitin 2020 del të jetë 40:1.

4 Raporti "Borgjezia e Akademisë", 2019, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2017/02/Borgjezia-e-Akademis%C3%AB-1.pdf>

5 Raporti "Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës-Menaxhimi i Financave" 2020, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/01/01-Shpenzimet-e-universiteteve-publike-ALB-01.pdf>

6 Raporti "Statistikat e arsimit në Kosovë 2020/21" i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, linku: <https://ask.rks-gov.net/media/6072/statistikat-e-arsimit-20202021.pdf>


GJETJET KRYESORE

Që nga matja e parë në vitin 2018, stafi akademik i universiteteve publike në Kosovë vazhdon të ketë shtesa enorme në shumën mujore prej të cilës paguhen, mirëpo në matjet e fundit këto shtesa kanë nisur të bien në disa prej universiteteve publike e në disa po vazhdojnë të rriten.

Bazuar në deklaratimet e pasurisë të vitit 2021 të stafit akademik menaxherial, Universiteti i Gjilanit ka më së shumti shtesa mujore me një mesatare prej 838 Euro. I dyti për nga numri i lartë i shtesave vjen Universiteti i Gjakovës me 786 Euro, i treti është Universiteti i Pejës me një mesatare prej 741 Euro, ndërkohë që i katërti për nga renditja është Universiteti i Mitrovicës me 693 Euro në muaj, ndërkohë që i pesti është Universiteti i Prizrenit me një mesatare prej 631 Euro shtesa në muaj.

Tek shumat më të ulëta të shtesave mujore, është Universiteti i Ferizajt me 496 Euro në muaj që përsëri është një shumë e lartë, si dhe Universiteti i Prishtinës i cili e ka mesataren më të ulët nga të gjitha universitetet e tjera publike sa i përket mesatares së shtesave mujore me një shumë prej 371 Euro. *(Shih grafikën)*

TË ARDHURAT DHE SHTESAT E STAFIT MENAXHERIAL NË UNIVERSITETET PUBLIKE




Kur jemi tek mesatarja e të ardhurave mujore dhe të shtesave të krahasuara mes gjashtë universiteteve publike që janë në kuadër të Ministrisë së Arsimit, del që ato kanë pësuar rënie graduale ndër vite.

Ndërsa, Universiteti i Prishtinës nuk është përfshirë në këtë matje për arsye se ka rënie drastike të numrit apo shumës së shtesave dhe në këtë mënyrë UP e ulë mesataren e përgjithshme të shtesave kur nuk është rasti i njëjtë edhe me universitetet e tjera.

Andaj në gjashtë universitetet e tjera publike, nga 1 mijë e 964 Euro sa ishte mesatarja e të ardhurave mujore të stafit akademik menaxherial në vitin 2019, është zbritur në 1 mijë e 902 Euro gjatë vitit 2020 dhe është rritur në 1 mijë e 914 Euro në vitin 2021.

Edhe mesatarja e shtesave mujore ka shënuar rënie përgjatë viteve kur në vitin 2019 ishte 802 Euro, në vitin 2020 kishte rënë në 720 Euro ndërkaq në vitin 2021 kjo shumë është zbritur përsëri në 697 Euro. *(Shih grafikën)*

SHTESAT E STAFIT MENAXHERIAL TË UNIVERSITETEVE PUBLIKE PËRGJATË VITEVE PA E PËRFSHIRË UP-NË



Zyra Kombëtare e Auditimit në Raportin për Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për vitin 2020⁷, ka përsëritur gjetjen e vitit të kaluar se si katër nga gjashtë universitetet publike me aprovime të këshillave drejtuese kishin përfshirë në rregullore, kompensime shtesë për pjesëmarrje në disa lloje të komisioneve që konsiderohen si jostatutare. Raste të njëjta gjenden edhe në raportet e auditorit për vitin 2018⁸, 2019⁹ dhe 2020¹⁰, pra këto rekomandime vazhdojnë të mos zbatohen.

Sipas këtij raporti, Ligji për Menaxhimin e Financave Publike¹¹ nuk lejon kompensimin shtesë nëse një punonjës, shërbyes civil ose zyrtar i një autoriteti publik sipas një akti të Qeverisë kërkohet që të shërbejë në një komision, bord ose autoritet tjetër publik. Meqenëse shërbimi konsiderohet pjesë e detyrave të obligueshme gjatë orarit të punës për postin të cilin e mban punonjësi.

Katër nga gjashtë universitetet në kuadër të MASHT-it, me aprovime të këshillave drejtuese kishin përfshirë në rregullore kompensime shtesë për pjesëmarrje në disa komisione siç janë për pjesëmarrje në hapje dhe vlerësimin e ofertave të prokurimit, regjistrimin dhe vlerësimin e pasurisë, planifikimin e buxhetit, pranimin e studentëve të rinj, për ankesa dhe parashtresa, rekrutim të stafit, ndarjen e bursave, hartimin e strategjive dhe rregulloreve mbështetëse, etj.

Bëhet fjalë për Universitetin e Gjakovës me shumë prej 2 mijë e 845 Euro, Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj me shumë prej 3 mijë e 10 Euro, Universitetin e Gjilanit me shumë prej 9 mijë e 245 Euro, si dhe Universitetin e Prizrenit me shumë prej 27 mijë e 650 Euro.

“Ne vlerësojmë se disa pika të këtyre rregulloreve bien ndesh me kornizën ligjore për menaxhimin e financave publike, respektivisht janë në kundërshtim me nenin 80 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, pasi që angazhimi në punë gjatë orarit të rregullt do të duhej të jetë pjesë e pandashme e detyrave të punës për të cilën punonjësit e marrin pagën bazë. Përkundër rekomandimit nga viti i kaluar, tri Universitete ende

7 Raporti i Auditimit për pasqyrat financiar të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për vitin 2020, linku: https://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2021/07/RaportiAuditimit_MASHTI_2020_Shqip.pdf

8 Raporti i Auditimit për pasqyrat financiar të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për vitin 2018, fq. 33, linku: <http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2019/06/Raporti-MASHT-E.pdf>

9 Raporti i Auditimit për pasqyrat financiar të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për vitin 2019, fq. 30, linku: <http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2020/07/Raporti-i-auditimit-MASHT-2019-Shqip.pdf>

10 Raporti i Auditimit për pasqyrat financiar të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për vitin 2020, fq.38, linku: https://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2021/07/RaportiAuditimit_MASHTI_2020_Shqip.pdf

11 Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, 2008, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2524>

nuk kanë ndërmarrë veprime për plotësim ndryshimin e rregulloreve për kompensimin e komisioneve të brendshme.”¹², thuhet në raport.

Në Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë për vitin 2017-2021¹³ (PSAK), për arsimin e lartë janë ndarë 5 milionë e 99 mijë Euro për vitin 2020, ndërkaq për vitin 2021, janë planifikuar të shpenzohen 7 milionë e 357 mijë Euro nga 22 milionë e 232 mijë e 500 Euro sa ishte gjithsej për periudhën 2017-2021.

Sa i përket kategorive ekonomike, vetëm në paga dhe mëditje ishin planifikuar të shpenzohen 9 milionë e 478 mijë Euro, ndërsa për subvencione dhe transfere, ishin paraparë të shpenzohen 7 milionë e 600 mijë Euro. Për arsimin e lartë, sipas Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë për vitin 2017-2021 MASHTI i ndanë 7 milionë e 636 mijë Euro, agjencitë e tjera 10 milionë e 488 mijë Euro, ndërkaq donatorët 4 milionë e 108 mijë Euro, pra gjithsej 22 milionë e 232 mijë Euro për periudhën pesë vjeçare¹⁴.

Qendra për Arsim e Kosovës¹⁵ (KEC) në projektin Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim (KEEN), në vlerësimin afatmesëm të zbatimit të PSAK-së tregonte se nga Fondi për Shkencë, MASHTI kishte ndarë nga 396 mijë Euro në vitin 2017 dhe në vitin 2018, ndërkohë që në vitin 2019, kishte ndarë 1 milion e 252 mijë Euro.¹⁶

Në raportin “‘Borgjezia’ e Akademisë” (2019), ORCA kishte hulumtuar deklaratimet e pasurisë të vitit 2019 të stafit akademik menaxherial të të gjitha universiteteve publike në Kosovë, të publikuara në uebfaqen e Agjencisë Kundër Korrupsion. Në hulumtim ishin përfshirë Këshilli Drejtues, Rektori, prorektorët, dekanët, dhe prodekanët e shtatë universiteteve publike. Të ardhurat mesatare ishin 2013 Euro në muaj, prej të cilave 836 Euro janë shtesa.¹⁷

12 Raporti i Auditimit për pasqyrat financiar të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për vitin 2020”, fq. 25, linku: https://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2021/07/RaportiAuditimit_MASHTI_2020_Shqip.pdf

13 Planit Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021, 2016, fq. 107, linku: https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-psak-2017-2021_1.pdf

14 Planit Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021, 2016, fq. 109, linku: https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-psak-2017-2021_1.pdf

15 Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), linku: <https://kec-ks.org/>

16 KEEN, 2019. VLERËSIM AFATMESËM: Zbatimi i Planit Strategjik për Arsimin në Kosovë 2017-2021


17 Raporti “Borgjezia e Akademisë”, 2019, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2017/02/Borgjezia-e-Akademis%C3%AB-1.pdf>

Ndërkaq në hulumtimin e deklaratave të pasurisë të vitit 2020 për stafin akademik menaxherial të universiteteve publike të Kosovës¹⁸, ORCA kishte gjetur se 159 profesorë me pozita menaxheriale në universitete publike paguhën mesatarisht 1916 Euro në muaj, nga të cilat mbi 696 Euro janë shtesa (36% e të ardhurave mujore).

Në hulumtimin e deklaratave të pasurisë të vitit 2021 për stafin akademik menaxherial të të gjitha universiteteve publike të vitit 2021, ORCA ka gjetur se 158 profesorë me pozita menaxheriale në universitetet publike të Kosovës paguhën mesatarisht 1804 Euro në muaj, nga të cilat mbi 574 Euro janë shtesa (31% e të ardhurave mujore).

Që nga viti 2019 e tutje ka rënie të të ardhurave mesatare, si dhe të shtesave.

SHTESAT E STAFIT MENAXHERIAL TË UNIVERSITETEVE PUBLIKE PËRGJATË VITEVE PËRFSHIRË UP-NË




Rektorët e universiteteve publike paguhën mesatarisht 2298 Euro në muaj, nga të cilat mesatarisht 939 Euro janë shtesa. Rektori i cili paguhet më së shumti në universitete publike është Fadil Millaku, rektor i Universitetit të Pejës, me 2 mijë e 554 Euro në muaj. Më pas

¹⁸ Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës 2-Menaxhimi i Financave, tetor 2020, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/10/Menaxhimi-i-financave-2.pdf>


është rektori i Universitetit të Gjakovës, Artan Nimani me 2 mijë e 465 Euro, ndërsa rektori që paguhet më së paku është Naser Sahiti nga Universiteti i Prishtinës me 1 mijë e 858 Euro.

TË ARDHURAT E REKTORËVE TË UNIVERSITETEVE PUBLIKE




Ka rënie krahasuar me deklarinimet e pasurisë të vitit 2020 ku mesatarja e të ardhurave ishte 2 mijë e 597 Euro në muaj, nga të cilat 1 mijë e 243 Euro ishin shtesa, dhe të vitit 2019 ku mesatarja ishte 2 mijë e 517 Euro në muaj, prej të cilave 1 mijë e 171 Euro ishin shtesa.

TË ARDHURAT E REKTORËVE NDËRVITE




Prorektorët e universiteteve publike paguhën mesatarisht 2053 Euro në muaj, nga të cilat mesatarisht 785 Euro janë shtesa. Prorektori i cili paguhet më së shumti në universitete publike është Vjollca Dibra, prorektore në Universitetin e Gjakovës, me 2 mijë e 603 Euro në muaj.

5 PROREKTORËT ME TË ARDHURAT MË TË LARTA NË UNIVERSITETET PUBLIKE




Këto shifra tregojnë për një rënie të shtesave krahasuar me deklarinimet e pasurisë të vitit 2020 ku të ardhurat mesatare të prorektorëve ishin 2 mijë e 132 Euro në muaj, prej të cilave 863 Euro ishin shtesa, dhe të vitit 2019 ku mesatarja ishte 2 mijë e 301 Euro, prej të cilave 1 mijë e 81 Euro ishin shtesa.

TË ARDHURAT E PROREKTORËVE NDËRVITE




Dekanët e universiteteve publike paguhet mesatarisht 1934 Euro në muaj, nga të cilat mesatarisht 672 Euro janë shtesa. Dekani i cili paguhet më së shumti në universitete publike është Idriz Berisha, dekan i Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin e Gjakovës, me 2 mijë e 463 Euro në muaj.

5 DEKANËT ME TË ARDHURAT MË TË LARTA NË UNIVERSITETET PUBLIKE




Ka një rënie të shtesave krahasuar me deklaratimet e pasurisë të vitit 2020 ku të ardhurat mesatare ishin 2 mijë e 20 Euro në muaj, prej të cilave 837 ishin shtesa, dhe të vitit 2019 ku mesatarja ishte 2 mijë e 517 Euro në muaj, prej të cilave 1 mijë e 171 Euro ishin shtesa.

TË ARDHURAT E DEKANËVE NDËRVITE




Prodekanët e universiteteve publike paguhën mesatarisht 1613 Euro në muaj, nga të cilat mesatarisht 400 Euro janë shtesa. Prodekan i cili paguhet më së shumti në universitete publike është Hamdi Hoti, prodekan i Fakultetit Ekonomik në Universitetin e Prizrenit, me 2 mijë e 284 Euro në muaj.

5 PRODEKANËT ME TË ARDHURAT MË TË LARTA NË UNIVERSITETET PUBLIKE



Ka një rënie të shtesave krahasuar me deklaratimet e pasurisë të vitit 2020 ku të ardhurat mesatare ishin 1 mijë e 798 Euro në muaj, prej të cilave 581 Euro ishin shtesa, dhe të vitit 2019 ku mesatarja e të ardhurave ishte 1 mijë e 927 Euro në muaj, prej të cilave 702 Euro ishin shtesa.

TË ARDHURAT E PRODEKANËVE NDËR VITE



Bazuar në deklaratimet e pasurisë të publikuara në vitin 2021 nga Agjencia Kundër Korrupsion, Vjollca Dibra, prorektore në Universitetin e Gjakovës, është më e paguara nga i gjithë stafi menaxherial i universiteteve publike me 2603 Euro në muaj. Krahasimisht, rroga më e lartë në Kosovë, ajo e presidentes është 2390 Euro në muaj, sipas ligjit të pagave për sektorin publik.¹⁹ Mesatarja e shpenzimeve për kokë studenti në universitete publike në vitin 2020, është 796 Euro. Ndërsa bazuar në ndarjet buxhetore për vitin 2021, mesatarja e shpenzimeve për studentë i bie të jetë 828 Euro.

¹⁹ Ligji Për Pagat Në Sektorin Publik, 2019, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18683>



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës²⁰, Universiteti i Prishtinës (UP) për vitin akademik 2020/2021 ka gjithsej 905 punonjës akademikë të rregullt dhe 380 të angazhuar, ndërsaq në vitin akademik 2019/20 kishte 891 të rregullt dhe 473 të angazhuar.

Në nivelin Bachelor për vitin akademik 2020/21, UP ka gjithsej 27 mijë e 124 studentë, për krahasim në vitin akademik 2019/20 kishte 29 mijë e 531, në nivelin Master për vitin akademik 2020/21 ka gjithsej 5 mijë e 836 studentë, për krahasim me vitin e kaluar kur kishte 6 mijë e 64 studentë, ndërsa kandidatë të pranuar në studimet e doktoratës për vitin akademik 2020/21 ka gjithsej 39, përderisa gjatë vitit akademik 2019/20 kishte 78.

Numri i studentëve në Universitetin e Prishtinës

	BA			MA			PhD		
			Gjithsej			Gjithsej			Gjithsej
2019/20	17,898	11,633	29,531	3,687	2,377	6,064	53	25	78
2020/21	16,860	10,264	27,124	3,766	2,070	5,836	21	18	39

Raporti student-mësimdhënës në Universitetin e Prishtinës për këtë periudhë del të jetë 36:1.

²⁰ Raporti "Statistikat e arsimit në Kosovë 2020/21" i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, fq.84, linku: https://ask.riks-gov.net/media/5460/statistikat-e-arsimit-n%C3%AB-kosov%C3%AB_2019-20_gjuheshqipe.pdf

Numri i të diplomuarve në Universitetin e Prishtinës

	BA			MA		
			Gjithsej			Gjithsej
2018/19	2,979	1,798	4,777	975	829	1804
2019/20	2,585	1,285	3,870	721	517	1238

Analiza e shpenzimeve

Nga thesari i buxhetit të Kosovës²¹, për Universitetin e Prishtinës ishin ndarë gjithsej 31 milionë e 141 mijë e 822 Euro për vitin 2020 ndërsa ishin shpenzuar 30 milionë e 929 mijë e 976 Euro. Kurse për vitin 2021, janë ndarë apo planifikuar të shpenzohen 31 milionë e 15 mijë e 38 Euro.

Për krahasim, në vitin 2019 nga buxheti i Kosovës²² ishin shpenzuar gjithsej 26 milionë e 787 mijë e 752 Euro.

59% e buxhetit të ndarë për këtë universitet për vitin 2020, është shpenzuar për paga dhe mëditje të stafit akademik, me 18 milionë e 327 mijë e 239 Euro, të parapara për 2 mijë e 81 të punësuar. Krahasuar me vitin 2019, kur për paga dhe mëditje ishin shpenzuar 18 milionë e 604 mijë e 884 Euro, duket se kjo shumë ka rënë për mbi 200 mijë Euro. Ndërkaq për vitin 2021, janë ndarë 18 milionë e 432 mijë e 170 Euro apo 68% e buxhetit total²³.

Për mallra dhe shërbime, UP kishte shpenzuar 3 milionë e 183 mijë e 954 Euro gjatë vitit 2020, ndërkohë që gjatë vitit 2019, ishin shpenzuar 3 milionë e 164 mijë e 86 Euro, pra në krahasim me vitin e kaluar kjo shumë është rritur për mbi 19 mijë euro. Ndërkaq për vitin 2021, janë ndarë 3 milionë e 63 mijë e 822 Euro.

Për shpenzime komunale gjatë vitit 2020, janë shpenzuar 1 milionë e 175 mijë **Euro**, ndërkaq gjatë vitit 2019, ishte shpenzuar shuma e njëjtë. Shuma e shpenzuar dhe e ndarë për subvencione dhe transfere në UP, përgjatë viteve 2021, 2020 dhe 2019 nuk ka ndryshuar,

21 Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, linku: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/23991BEA-4CD9-40B3-94D3-EA192C572464.pdf>

22 Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, linku: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/4CEFBA4C-4397-4901-AB93-2AA37F43A9F7.pdf>

23 Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, linku: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/5EA509E4-2933-4524-BD0F-5466A661486F.pdf>



LINJA BUXHETORE PËR UNIVERSITETIN E PRISHTINËS 2019, 2020 DHE 2021

Pagat dhe mëditjet	2019	18,604,884	69%
	2020	18,327,239	59%
	2021	18,432,170	68%
Mallrat dhe shërbimet	2019	3,164,086	12%
	2020	3,183,954	10%
	2021	3,063,822	11%
Shpenzimet komunale	2019	1,175,000	4%
	2020	1,175,000	4%
	2021	1,175,000	4%
Subvencionet dhe transferet	2019	343,782	1%
	2020	343,782	1%
	2021	343,782	1%
Shpenzimet kapitale	2019	3,500,000	13%
	2020	7,900,001	26%
	2021	4,000,000	15%
Total Shpenzimet	2019	26,787,752	100%
	2020	30,929,976	
	2021	27,014,774	

pra është nga 343 mijë e 782 Euro. Buxheti i ndarë për shpenzime kapitale dallon mes këtyre viteve për mbi 3 milionë Euro, meqenëse për vitin 2020, janë shpenzuar gjithsej 7 milionë e 900 mijë Euro, ndërsa për vitin 2019, ishin shpenzuar 3 milionë e 500 Euro. Ndërkaq për vitin 2021, janë ndarë 4 milionë Euro.

Në anën tjetër, shpenzimet vjetore për kokë studenti për vitin 2021 në Universitetin e Prishtinës janë vetëm 941 Euro. Për krahasim, vitin e kaluar kanë qenë 870 Euro.

Shumës së përgjithshme të buxhetit të ndarë nga Qeveria e Kosovës, UP i kishte shtuar edhe 3 milionë e 997 mijë e 750 Euro nga të hyrat vetanake, sipas ligjit mbi ndarjet buxhetore për vitin 2020.

Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Prishtinës

Pagat e profesorëve dhe shtesat në Universitetin e Prishtinës janë të rregulluara përmes Rregullores nr. 2/486 të datës 11.09.2017 për të ardhura personale të personelit akademik, shtesat për funksione, honorarët dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina".

Neni 8 i kësaj rregullore, përcakton kompensimin e personelit akademik me normë të plotë, sipas kësaj tablele:

Titulli	Orë në javë	Paga mujore
Profesorët e rregullt	 6	1429.54 Euro
Profesorët e asocuar	 6	1283.34 Euro
Profesorët asistent	 6	1137.14 Euro
Ligjëruesit	 6	990.94 Euro
Lektorët	 10	844.73 Euro
Korepetitorët	 10	844.73 Euro
Asistentët	 10	772.50 Euro
Asistent i ri	 10	698.75 Euro

Tabela 1. Pagat bazë të personelit akademik në Universitetin e Prishtinës

Po ashtu, përtej pagës bazë, stafi akademik i cili ushtron detyra menaxheriale në kuadër të Universitetit të Prishtinës, kompensohet sipas kësaj tablele:

Pozita	Shtesa
Rektor	500 Euro
Prorektor	450 Euro
Dekan	350 Euro
Prodekan	250 Euro

Tabela 2. Shtesat për pozita menaxheriale në Universitetin e Prishtinës

Personeli akademik në Universitet të Prishtinës ka të drejtë të angazhohet në orë shtesë

(mbi-norma) deri në 6 orë në javë (profesorët) dhe deri në 10 orë në javë (lektorët, asistentët e korepetitorët). Këto orë shtesë kompensohen sipas kësaj tablele:

Titulli	Shtesa
Profesorë (të rregullt, të asocuar dhe asistent)	25 Euro
Ligjërues, lektor	15 Euro
Asistent, korepetitorë	13 Euro

Tabela 3. Kompensimet e mbi-normës

Personeli akademik po ashtu kompensohet për mentorimin e temave të diplomës, si dhe për pjesëmarrjen në komisione të vlerësimit të temës së diplomës, në nivelet BA, MA dhe PhD.

Komisioni	BA	MA	PHD
Mentori	20 Euro	150 Euro	1200 Euro
Kryetari i komisionit	n/a	60 Euro	200 Euro
Anëtar i komisionit	10 Euro	50 Euro	150 Euro


Tabela 4. Kompensimet e mentorimeve të temave të diplomës

Personeli akademik gjithashtu kompensohet edhe për pjesëmarrje në komisione të ndryshme në kuadër të punës në universitet, si dhe për pjesëmarrje në Senat, sipas nenit 22.

Analiza e të dhënave nga deklaratimet e pasurisë

Në analizën e deklaratave të pasurisë për Universitetin e Prishtinës janë përfshirë anëtarët e Këshillit Drejtues (vetëm anëtarët me titull akademik), rektori, prorektorët, dekanët dhe prodekanët.


SHTESAT E STAFIT MENAXHERIAL NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS NDËR VITE



Në përgjithësi të ardhurat mujore të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Prishtinës kanë rënë dukshëm. Derisa në vitin 2019 mesatarja e të ardhurave mujore ishte 2 mijë e 177 Euro, në vitin 2020 kjo ka rënë në 1 mijë e 979 Euro, ndërsa në vitin 2021 kjo shumë ka vazhduar rënien deri në 1 mijë e 625 Euro.

Ndërkaq shtesat mujore gjithashtu kanë pësuar një rënie drastike nga 886 Euro sa ishin në vitin 2019, në 699 Euro gjatë vitit 2020 dhe tani mesatarja ka rënë në 371 Euro.

TË ARDHURAT MUJORE PËRGJATË VITEVE SIPAS POZITAVE - UNIVERSITETI I PRISHTINËS




Anëtarët e Këshillit Drejtues me titull akademik mesatarisht paguhen 1813 Euro në muaj nga buxheti i Universitetit, ku mesatarisht ata marrin 472 Euro në muaj në shtesa. Këto shtesa përbëjnë rreth 26% të rrogës së tyre mujore. Këto shifra tregojnë për një rritje të shtesave krahasuar me deklarinimet e pasurisë të vitit 2020 ku të ardhurat mesatare ishin 1736 Euro në muaj dhe shtesat mesatare 405 Euro në muaj. Megjithatë, në deklarinimet e pasurisë të vitit 2019, të ardhurat mesatare mujore ishin më të larta, me 2381 Euro në muaj, prej tyre mesatarisht 988 Euro shtesa.

Anëtarët e Rektoratit mesatarisht paguhen 1719 Euro në muaj nga buxheti i universitetit, ku 406 Euro janë shtesa. Këto shtesa përbëjnë rreth 27% të rrogës së tyre mujore. Ka rënie domethënëse nga deklarinimet e pasurisë të vitit 2020 ku të ardhurat mesatare ishin 2521 Euro dhe shtesat mesatare 1120 Euro në muaj. Të ardhura më të larta kishte edhe në deklarinimet e pasurisë të vitit 2019, me mesatarisht 2555 Euro në muaj, prej tyre 1184 Euro shtesa.²⁴

Dekanët e fakulteteve mesatarisht paguhen 1847 Euro në muaj nga buxheti i universitetit, ku 543 Euro janë shtesa. Këto shtesa përbëjnë rreth 29% të rrogës së tyre mujore. Këto shifra tregojnë për një rënie të shtesave krahasuar me deklarinimet e pasurisë së vitit 2020 ku të ardhurat mesatare ishin 2232 Euro në muaj dhe shtesat mesatare 895 Euro në muaj dhe të vitit 2019 ku mesatarja e të ardhurave ishte 2418 Euro në muaj dhe e shtesave 1069 Euro në muaj.

Prodekanët e fakulteteve mesatarisht paguhen 1488 Euro në muaj nga buxheti i universitetit, ku 280 Euro janë shtesa. Këto shtesa përbëjnë rreth 19% të rrogës së tyre mujore. Ka rënie të shtesave krahasuar me deklarinimet e pasurisë të vitit 2020 ku të ardhurat mesatare ishin 1841 Euro në muaj dhe shtesat mesatare 606 Euro në muaj. Në deklarinimet e pasurisë të vitit 2019 shtesat ishin edhe më të larta, ku të ardhurat mesatare mujore ishin 2000 Euro, prej të cilave 730 Euro ishin shtesa.

SHTESAT PËRGJATË VITEVE SIPAS POZITAVE - UNIVERSITETI I PRISHTINËS



²⁴ Kjo rënie e shtesave mund të shpjegohet me faktin se përbërja e re e rektoratit është vetëm nga tetori i vitit 2020, prej edhe kur kanë filluar t'i marrin shtesat funksionale, ndërsa shumica e deklarimeve janë për gjithë vitin 2020.

Për herë të parë, asnjë profesor nga stafi menaxherial i Universitetit të Prishtinës nuk ka shtesa më të larta se rroga bazë. Në analizën e deklarimeve të pasurisë të vitit 2020, katër profesorë kanë pasur më shumë shtesa sesa rroga bazë, dy ishin prorektorë dhe dy ishin prodekanë.

Fondi për shkencë

Në vitin 2020, nga kategoria kuotizime dhe botime, UP ka shpenzuar vetëm 2 mijë e 485 Euro, të cilat sipas Raportit Vjetor, janë përdorë kryesisht për pjesëmarrje në konferenca. Ndërkaq për vitin 2021, sipas Rregullores për financimin e veprimtarisë shkencore-kërkimore, artistike dhe sportive të Universitetit të Prishtinës (nr. prot. 3/879, datë 11.12.2020)²⁵, është planifikuar të shpenzohet 1% e buxhetit të përgjithshëm të UP-së apo 310 mijë e 125 Euro.

Për krahasim, në vitin 2019 nuk kishte informacion publik për shpenzimet e paguara

²⁵ Rregullore për financimin e veprimtarisë shkencore-kërkimore, artistike dhe sportive të Universitetit të Prishtinës (nr. prot. 3/879, datë 11.12.2020), rregullore, linku: <https://dokumente.uni-pr.edu/>



Të dhënat e detajuara sipas deklarimeve të pasurisë të vitit 2021, me shumatat që paraqesin të ardhurat vjetore të pjesëtuara për 12 muaj mund t'i gjeni në **aneksin numër 1.**

		2019	2020	2021
Mesatarja e të ardhurave mujore	Këshilli Drejtues	2381 €	1736 €	1,813 €
	Rektorati	2555 €	2521 €	1,719 €
	Dekanët	2418 €	2232 €	1,847 €
	Prodekanët	2000 €	1804 €	1,488 €
Mesatarja e shtesave	Këshilli Drejtues	988 €	405 €	472 €
	Rektorati	1184 €	1120 €	406 €
	Dekanët	1068 €	895 €	543 €
	Prodekanët	730 €	606 €	280 €
Minimumi dhe maksimumi i të ardhurave mujore	Këshilli Drejtues	2200 €, 2630 €	1313 €, 1995 €	1,650 €, 1,942 €
	Rektorati	2072 €, 3125 €	1980 €, 2930 €	1,215 €, 1,985 €
	Dekanët	1910 €, 3367 €	1743 €, 2706 €	1,354 €, 2,429 €
	Prodekanët	1283 €, 3352 €	1283 €, 2707 €	796 €, 2,117 €
Minimumi dhe maksimumi i shtesave	Këshilli Drejtues	815 €, 1200 €	177 €, 566 €	367 €, 566 €
	Rektorati	861 €, 1694 €	697 €, 1501 €	78 €, 556 €
	Dekanët	505 €, 1937 €	606 €, 1277 €	129 €, 1,011 €
	Prodekanët	0, 1922 €	103 €, 1423 €	24 €, 700 €



Sipas Raportit Vjetor për vitin 2020, UP kishte ndarë bursa në vlerë prej

650 Euro për **1 mijë e 67 studentë**, shuma totale e të cilave arrin në **693 mijë e 550 Euro**.

për këtë kategori ndërkaq sipas ndarjeve të buxhetit për vitin 2020, nga kategoria subvencione dhe transfere bëhej financimi i aktiviteteve shkencore në UP në vlerë prej 1% të buxhetit të përgjithshëm të universitetit ose në shumën prej 367 mijë e 339 Euro.

Bursa për studentë

Sipas Raportit Vjetor për vitin 2020²⁶, UP kishte ndarë bursa në vlerë prej 650 Euro për 1 mijë e 67 studentë, shuma totale e të cilave arrin në 693 mijë e 550 Euro. Ndërkaq për vitin 2021, UP ka ndarë bursa në vlerë prej 650 Euro për 1 mijë e 290 studentë, shuma totale e të cilave arrin në 774 mijë Euro. Për krahasim me vitin 2019, UP kishte ndarë bursa për 1 mijë e 58²⁷ studentë, me shumën prej 600 Euro për 10 muaj të vitit akademik, shumë kjo e cila kapte vlerën prej 653 mijë e 319 Euro.

Investimet kryesore kapitale

Investimet kapitale gjatë vitit 2020 ishin 1 milion e 899 mijë e 906 Euro, kurse në vitin 2021 në këtë kategori, UP ka të planifikuara 4 milion Euro. Gjatë vitit 2020, UP ka investuar më së shumti për këto tri projekte: laboratorë për UP në vlerë prej 390 mijë e 309 Euro, themelimin e qendrës për zhvillim, transferim dhe implementim e teknologjive të reja në prodhimtari në vlerë prej 385 mijë e 270 Euro, si dhe në themelimin e qendrës për hulumtime bashkëkohore në fushën e inxhinierisë elektrike dhe informacionit në vlerë prej 298 mijë e 750 Euro.

Për krahasim, sipas Raportit të Auditorit për UP-në, në vitin 2019 ishin shpenzuar gjithsej 3 milionë e 90 mijë e 155 Euro për investime kapitale dhe se kryesisht ishin bërë furnizime me pajisje laboratorike, renovim i objekteve universitare, etj. Sipas ndarjeve të buxhetit për vitin 2020, UP kishte tri projekte të mëdha: Revitalizimin e laboratorëve në FSHMN 2018-2020 me shumën prej 800 mijë Euro, hidroizolim dhe drenazhimin e themeleve dhe bodrumeve në objektet e FSHMN, F. Filozofik dhe F. Filologjik me shumë prej 800 mijë Euro, si dhe ndërtimin e objektit për FSHMN me shumën prej 450 mijë Euro.

Mirëpo sipas Raportit Vjetor të Universitetit të Prishtinës për vitin 2020 dhe sipas Zyrës së Financave në UP, gjatë vitit 2020 nuk kanë arritur t'i realizojnë këto investime dhe për këto shkaqe: Në projektin: "Revitalizimi i laboratorëve në FSHMN" nuk janë zhvilluar procedurat e

26 Raport vjetor, Shkresë përcjellëse MASHTI-t me Raportin Vjetor 2020 të Universitetit të Prishtinës, fq.16, linku: <https://dokumente.uni-pr.edu/>

27 Lista e bursistëve të UP-së, 2018/19, linku: https://drive.google.com/drive/folders/1Y-DQUwbbByHAs65ViOUkPRXn-1mD6Q3mB?fbclid=IwAR2_uYOhHUNIsMtriebyER8QI-7a1Eg2RB8lp6ZPuhwgnz-27uQ1baJ2E2j0

prokurimit për shkak të anulimit; Tek “Hidroizolimi dhe drenazhimi i bodrumeve dhe themeleve të objekteve të vjetra në FSHMN, F. Filozofik dhe F. Filologjik” gjatë vitit 2020 nuk ka pasur investime por vetëm kanë filluar procedurat e prokurimit; Tek “Ndërtimi i objektit të FSHMN dhe F. Ekonomik” në vitin 2020 nuk ka filluar për shkak të mungesës së lejes së ndërtimit.

Sigurimi fizik i objekteve

Nuk ka informata publike për shpenzimet e paguara për këtë kategori për vitin 2020, mirëpo në përgjigjet zyrtare të pranuar nga UP, thuhet se shuma e shpenzuar nga Universiteti i Prishtinës për sigurimin fizik të objekteve gjatë vitit 2020 ishte 577 mijë e 840 Euro, kurse për vitin 2021 janë planifikuar të shpenzohen 600 mijë Euro. Vetëm deri në muajin korrik 2021 janë shpenzuar 320 mijë e 425 Euro. Për vitin 2019 nuk kishte informacion publik për shpenzimet e paguara për sigurimin fizik të objekteve për një vit, mirëpo sipas përgjigjeve zyrtare të UP-së, gjatë vitit 2019 ishin shpenzuar gjithsej 575 mijë e 207 Euro për këtë kategori.

Shpenzimet gjyqësore

Në Raportin Vjetor Financiar të Buxhetit të Kosovës për vitin 2020²⁸, nga Thesari i Shtetit janë përdorë 321 mijë e 310 Euro për shpenzime gjyqësore.

Për krahasim, në Raportin Vjetor Financiar të Buxhetit të Kosovës për vitin 2019²⁹, nga Thesari i shtetit ishin shpenzuar gjithsej 465 mijë e 59 Euro si pasojë e vendimeve të gjykatave prej tyre 331 mijë e 775 Euro ishin obligime të viteve të mëhershme të UP-së ndaj ATK-së për kontributet pensionale dhe tatimet e mbajtura në burim për shtesat e profesorëve që nuk ishin paguar. Pjesa prej 133 mijë e 284 Euro ishin për pagesën e pagave jubilarë për stafin akademik dhe nga faturat që nuk ishin paguar me kohë. Prej tyre borxhi kryesor ishte 124 mijë e 272 Euro dhe shpenzime procedurale të gjykatës (përmbarimit) ishin 9 mijë e 12 Euro³⁰.



Nuk ka informata publike për shpenzimet e paguara për këtë kategori për vitin 2020, mirëpo në përgjigjet zyrtare të pranuar nga UP, thuhet se shuma e shpenzuar nga Universiteti i Prishtinës për sigurimin fizik të objekteve gjatë vitit 2020 ishte **577 mijë e 840 Euro**, kurse për vitin 2021 janë planifikuar të shpenzohen **600 mijë Euro**.

28 Raporti vjetor financiar i buxhetit të Republikës së Kosovës, aneksi nr.20, fq.95, 2020, linku: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/04E85A56-B508-41C1-A6D6-427A0C091EF0.pdf>

29 Raporti vjetor financiar i buxhetit të Republikës së Kosovës, 2019, linku: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/1E29A660-3716-465F-A1E8-C99AD78E6318.pdf>

30 Raporti i Auditimit për UP-në, 2019, linku: <http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2020/08/Raporti-auditimit-UP-2019-Shqip.pdf>



37 profesorë

në Universitetin e Prishtinës janë angazhuar me punë sekondare në universitete të tjera publike për të cilat nuk kishin marrë miratimin paraprak nga rektori i UP-së.

Gjetje nga Zyra Kombëtare e Auditimit

Në Raportin e Auditimit për Universitetin e Prishtinës për vitin 2020³¹, është gjetur se 37 profesorë në Universitetin e Prishtinës janë angazhuar me punë sekondare në universitete të tjera publike për të cilat nuk kishin marrë miratimin paraprak nga rektori i UP-së.

“Angazhimet e profesorëve për punë shtesë pa marrë miratimin e menaxhmentit, përveç se është në kundërshtim me kërkesat e rregullores për të ardhurat personale të personelit akademik, rritë rrezikun e humbjes së cilësisë në procesin arsimor për shkak të angazhimeve të shumta të personelit akademik”, thuhet në raport, ndërkohë që është rekomanduar rishikimi i rasteve të identifikuar dhe marrja e masave përkatëse ndaj personelit i cili nuk po i zbaton rregulloret e brendshme.

E gjetur tjetër është edhe vazhdimi i kompensimeve në kundërshtim me Rregulloren për Kompensimin e Punës së Komisioneve të cilat themelohen në nivel të universitetit, për arsye se kompensimi për punë shtesë dhe punë jashtë orarit nuk i takon rektorit, prorektorëve, anëtarëve të Këshillit Drejtues, sekretarit të përgjithshëm të UP-së, dekanëve, prodekanëve, sekretarëve të njësive akademike dhe drejtorëve të Administratës Qendrore, ndërkohë që sipas Raportit të Auditorit, në 13 raste janë kompensuar si anëtarë të komisionit për punë shtesë të cilat sipas zyrës për çështje akademike të UP-së, nuk konsiderohen si komisione profesionale apo komisione të rregullta. Vlera e këtyre kompensimeve ishte 1,892 Euro.

Sipas raportit, kjo kishte ndodhur për shkak se menaxhmenti nuk kishte marrë parasysh kufizimet e përcaktuara me rregulloren përkatëse, duke i konsideruar këto komisione si ndihmëse dhe profesionale.

“Kompensimet për pjesëmarrje në komisione të personelit të cilat janë në kundërshtim me rregulloren shkaktojnë pagesa të parregullta dhe dëmtim të buxhetit.”, thuhet tutje.

Ndërkohë që është rekomanduar që rektori duhet të sigurojë që nuk do të paguhet kompensime për pjesëmarrje në komisione, për personelin që sipas rregullores nuk u takon kompensimi dhe të rishikohet mundësia e kthimit të mjeteve.

³¹ Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Universitetit të Prishtinës, 2020, linku: https://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2021/07/RaportiAuditimit_UP_2020_Shqip.pdf

Tutje janë gjetur edhe mangësi në rregulloret e brendshme lidhur me kompensimin e shtesave funksionale

“Nga testimet tona, kemi vërejtur se kompensimi i Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit është i përfshirë në dy rregullore, duke përfshirë pagën bazë dhe kompensimin funksional. Paga bazë është e caktuar në bazë të Rregullores Nr. 3/525 për pagat për personelin e administratës, neni 4, në vlerë 1,429€ ndërsa kompensimi funksional në vlerë 250€ është i caktuar në nenin 9 të Rregullores Nr. 2/486 për të ardhurat personale të personelit akademik. Rrjedhimisht, pozita e Sekretarit të Përgjithshëm nuk klasifikohet në kategorinë e personelit akademik, përkatësisht kjo pozitë ka rolin e udhëheqësit më të lartë administrativ, dhe si e tillë nuk do të duhej të ishte e përfshirë në rregulloren për personelin akademik. Kjo kishte ndodhur për shkak se Këshilli Drejtues gjatë hartimit të rregullores përkatëse, nuk kishte marrë parasysh klasifikimin e pozitive të përcaktuara në Statutin e UP-së.”, thuhet në raport.

Ndërkaq është rekomanduar që rektori në bashkëpunim me Këshillin Drejtues të UP-së duhet të bëjë harmonizimin e rregulloreve të brendshme në pajtim me statutin e Universitetit, në mënyrë që kompensimet të jenë në pajtim me pozitat funksionale.

Auditorët kanë gjetur parregullsi edhe tek pagat dhe mëditjet përmes të cilave, është kërkuar nga rektori që t'i shtojë apo rrisë kontrollet për të siguruar se pagesat e bëra për kompensime të dokumentohen me dëshmi për kryerjen e punëve jashtë orarit të rregullt të punës.

“Në raste kur nuk ka dëshmi se të punësuarit kanë kryer punë jashtë orarit të rregullt të punës, kompensimet mos të bëhen dhe të ndërpriten menjëherë. Nuk kishte veprime të ndërmarra dhe gjendja është e njëjtë si në RA të vitit 2020. Nuk është adresuar”, thuhet në raport.

Nga nëntë rekomandimet që i kishte dhënë Zyra e Auditorit për vitin 2019, një ishte zbatuar, një nuk ishte më i aplikueshëm dhe shtatë prej tyre nuk ishin zbatuar fare.



Paga bazë është e caktuar në bazë të Rregullores **Nr. 3/525** për pagat për personelin e administratës, **neni 4**, në vlerë **1,429€** ndërsa kompensimi funksional në vlerë **250€** është i caktuar në **nenin 9** të Rregullores **Nr. 2/486** për të ardhurat personale të personelit akademik.



UNIVERSITETI I PRIZRENIT

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës³², Universiteti i Prizrenit (UPZ), për vitin akademik 2020-2021 ka gjithsej 80 punonjës akademik të rregullt, prej tyre 25 gra dhe 55 burra, si dhe 114 të angazhuar, prej tyre 39 gra dhe 75 burra. Krahësuar me vitin akademik 2019/2020, UPZ kishte gjithsej 77 punonjës akademik të rregullt, prej tyre 24 gra dhe 53 burra, si dhe 87 të angazhuar, prej tyre 32 gra dhe 55 burra.

Universiteti i Prizrenit, në nivelin Bachelor ka gjithsej 3 mijë e 982 studentë, në nivelin Master ka gjithsej 348 studentë, ndërsa nivelin e doktoratës nuk e ka.

Numri i studentëve në Universitetin e Prizrenit

	BA			MA			PhD		
			Gjithsej			Gjithsej			Gjithsej
2019/20	2,776	1,000	3,776	144	115	259	-	-	-
2020/21	2,750	1,232	3,982	172	176	348	-	-	-

Raporti student-mësimdhënës në Universitetin e Prizrenit në vitin 2020 del të jetë 54:1.

³² Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e arsimit në Kosovë 2020/21, fq. 84, linku: <https://ask.rks-gov.net/media/6072/statistikat-e-arsimit-20202021.pdf>

Numri i të diplomuarve në Universitetin e Prizrenit

	BA			MA		
			Gjithsej			Gjithsej
2018/19	620	237	857	109	92	201
2019/20	691	209	900	113	55	168

Analiza e shpenzimeve

Nga thesari i buxhetit të Kosovës, për Universitetin e Prizrenit, ishin ndarë gjithsej 2 milionë e 561 mijë e 12 Euro për vitin 2020, ndërsa ishin shpenzuar 2 milionë e 518 mijë e 728 Euro. Kurse për vitin 2021, është ndarë apo planifikuar të shpenzohet shuma e njëjtë prej 2 milionë e 518 mijë e 728 Euro.

Për krahasim, në vitin 2019 nga buxheti i Kosovës³³ ishin shpenzuar gjithsej 2 milionë e 570 mijë e 944 Euro.

61% e buxhetit për këtë universitet për vitin 2020, është shpenzuar për paga dhe mëditje të stafit akademik, me 1 milionë e 545 mijë e 728 Euro, të parapara për 147 të punësuar. Krahasuar me vitin 2019, kur për paga dhe mëditje ishin shpenzuar 1 milionë e 597 mijë e 944 Euro, duket se kjo shumë ka rënë për mbi 50 mijë Euro. Ndërkaq për vitin 2021, janë ndarë 1 milionë e 347 mijë e 540 Euro, apo 59%.³⁴

Për mallra dhe shërbime, UPZ kishte shpenzuar 600 mijë Euro gjatë vitit 2020, ndërkohë që edhe gjatë vitit 2019, ishte shpenzuar shuma e njëjtë prej 600 mijë Euro, si dhe për vitin 2021, është ndarë e njëjta.

³³ Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, linku: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/4CEFBA4C-4397-4901-AB93-2AA37F43A9F7.pdf>

³⁴ Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, linku: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/5EA509E4-2933-4524-BD0F-5466A661486F.pdf>



LINJA BUXHETORE PËR UNIVERSITETIN E PRIZRENIT 2019, 2020 DHE 2021

Pagat dhe mëditjet	2019	1,597,944	62%
	2020	1,545,728	61%
	2021	1,347,540	59%
Mallrat dhe shërbimet	2019	600,000	23%
	2020	600,000	24%
	2021	600,000	26%
Shpenzimet komunale	2019	73,000	3%
	2020	73,000	3%
	2021	73,000	3%
Subvencionet dhe transferet	2019	100,000	4%
	2020	100,000	4%
	2021	100,000	4%
Shpenzimet kapitale	2019	200,000	8%
	2020	200,000	8%
	2021	180,000	8%
Total Shpenzimet	2019	2,570,944	100%
	2020	2,518,728	
	2021	2,300,540	

Për shpenzime komunale gjatë vitit 2020, janë shpenzuar 73 mijë Euro, ndërsa gjatë vitit 2019, ishte shpenzuar shuma e njëjtë, si dhe ishte planifikuar e njëjta për vitin 2021. Shuma e shpenzuar dhe e ndarë për subvencione dhe transfere në UPZ, përgjatë viteve 2021, 2020 dhe 2019 nuk ka ndryshuar, pra është nga 100 mijë Euro. Buxheti i ndarë për shpenzime kapitale dallon mes viteve 2020/2019 dhe 2021 për 20 mijë Euro, meqenëse për vitin 2020 dhe 2019 ishin shpenzuar gjithsej nga 200 mijë Euro, ndërsa për vitin 2021, janë ndarë 180 mijë Euro.

Shpenzimet vjetore për kokë studenti, në Universitetin e Prizrenit për vitin 2021 janë vetëm 645 Euro. Për krahasim, vitin e kaluar kanë qenë 556 Euro.

Shumës së përgjithshme të buxhetit të ndarë nga Qeveria e Kosovës, UPZ i kishte shtuar edhe 105 mijë Euro nga të hyrat vetanake, sipas ligjit mbi ndarjet buxhetore për vitin 2020.

Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Prizrenit

Pagat e profesorëve dhe shtesat në Universitetin e Prizrenit janë të rregulluara përmes Rregullores të datës 18.01.2019 për të ardhura personale të personelit akademik, shtesat për funksione, honorarët dhe komisionet e përhershme në Universitetin “Ukshin Hoti”.³⁵ Neni 8 i kësaj rregullore, përcakton kompensimin e personelit akademik me normë të plotë, sipas kësaj tablele:

Titulli	Orë në javë	Paga mujore
Profesorët e rregullt	 6	1486.72 Euro
Profesorët e asocuar	 6	1334.67 Euro
Profesorët asistent	 6	1182.62 Euro
Ligjëruesit	 6	1030.57 Euro
Lektorët	 10	878.52 Euro
Korepetitorët	 10	878.52 Euro
Asistentët	 10	803.40 Euro
Asistent i ri	 10	726.70 Euro

Tabela 1. Pagat bazë të personelit akademik në Universitetin e Prizrenit

Po ashtu, përtej pagës bazë, stafi akademik i cili ushtron detyra menaxheriale në kuadër të Universitetit të Prizrenit, kompensohet sipas kësaj tablele:

Pozita	Shtesa
Rektor	600 Euro
Prorektor	450 Euro
Dekan	350 Euro
Prodekan	250 Euro

Tabela 2. Shtesat për pozita menaxheriale në Universitetin e Prizrenit

³⁵ Rregullorja për të ardhura personale të personelit akademik, shtesat për funksione, honorarët dhe komisionet e përhershme në Universitetin “Ukshin Hoti”. 18.01.2019, link: https://uni-prizren.com/repository/docs/RREGULLORJA_NR_01-11_-_2019_247988.pdf

Personeli akademik në Universitet të Prizrenit ka të drejtë të angazhohet në orë shtesë (mbi-norma) deri në 6 orë në javë (profesorët) dhe deri në 8 orë në javë (lektorët, asistentët e korepetitorët). Këto orë shtesë kompensohen sipas kësaj tablele:

Titulli	Shtesa
Profesorë (të rregullt, të asocuar dhe asistent)	25 Euro
Ligjërues, lektor	15 Euro
Asistent, korepetitorë	13 Euro

Tabela 3. Kompensimet e mbi-normës

Personeli akademik po ashtu kompensohet për mentorimin e temave të diplomës si dhe për pjesëmarrjen në komisione të vlerësimit të temës së diplomës, në nivelet BA, MA dhe PhD.

Komisioni	BA	MA	PHD
Mentori	20 Euro	150 Euro	1200 Euro
Kryetari i komisionit	n/a	50 Euro	300 Euro
Anëtar i komisionit	10 Euro	30 Euro	200 Euro


Tabela 4. Kompensimet e mentorimeve të temave të diplomës

Personeli akademik gjithashtu kompensohet edhe për pjesëmarrje në komisione të ndryshme në kuadër të punës në universitet, si dhe për pjesëmarrje në Senat, sipas neneve 20 dhe 21.

Analiza e të dhënave nga deklaratimet e pasurisë

Në analizën e deklaratimeve të pasurisë për Universitetin e Prizrenit janë përfshirë anëtarët e Këshillit Drejtues (vetëm anëtarët me titull akademik), rektori, prorektorët, dekanët dhe prodekanët.


SHTESAT E STAFIT MENAXHERIAL NË UNIVERSITETIN E PRIZRENIT NDËR VITE



Në të ardhurat mujore të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Prizrenit ka pasur lëvizje nga viti në vit por përsëri janë të larta. Derisa në vitin 2019 mesatarja e të ardhurave mujore ishte 1 mijë e 896 Euro, në vitin 2020 kjo është rritur në 1 mijë e 976 Euro, ndërsa në vitin 2021 ka rënë në 1 mijë e 870 Euro.

Ndërkaq shtesat mujore gjithashtu kanë pasur ndryshimet e ngjashme, nga 719 Euro sa ishin në vitin 2019, në 731 Euro gjatë vitit 2020 dhe tani mesatarja ka rënë në 631 Euro.

TË ARDHURAT MUJORE PËRGJATË VITEVE SIPAS POZITAVE - UNIVERSITETI I PRIZRENIT



Anëtarët e Këshillit Drejtues me titull akademik mesatarisht paguhën 1687 Euro në muaj nga buxheti i Universitetit, ku mesatarisht ata marrin 504 Euro në muaj në shtesa. Këto shtesa përbëjnë rreth 29% të rrogës së tyre mujore. Këto shifra tregojnë për një rënie të


shtesave krahasuar me deklarinmet e pasurisë të vitit 2020 ku të ardhurat mesatare ishin 1915 Euro në muaj dhe shtesat mesatare 733 Euro në muaj. Në deklarinmet e pasurisë të vitit 2019, të ardhurat mesatare mujore ishin 1604 Euro në muaj, prej tyre mesatarisht 364 Euro shtesa.

Anëtarët e Rektoratit mesatarisht paguhën 2064 Euro në muaj nga buxheti i universitetit, ku 805 Euro janë shtesa. Këto shtesa përbëjnë rreth 39% të rrogës së tyre mujore. Shifra të ngjashme ishin edhe në deklarinmet e pasurisë të vitit 2020 ku të ardhurat mesatare ishin 2080 Euro dhe shtesat mesatare 860 Euro në muaj. Shtesa më të larta ishin në vitin 2019, me mesatarisht 2199 Euro në muaj, prej tyre 989 Euro shtesa.

Dekanët e fakulteteve mesatarisht paguhën 1911 Euro në muaj nga buxheti i universitetit, ku 637 Euro janë shtesa. Këto shtesa përbëjnë rreth 33% të rrogës së tyre mujore. Këto shifra tregojnë për një zvogëlim të shtesave krahasuar me deklarinmet e pasurisë së vitit 2020 ku të ardhurat mesatare ishin 2208 Euro në muaj dhe shtesat mesatare 873 Euro në muaj. Në 2019 mesatarja e të ardhurave ishte 2120 Euro në muaj dhe e shtesave 861 Euro në muaj.

Prodekanët e fakulteteve mesatarisht paguhën 1828 Euro në muaj nga buxheti i universitetit, ku 594 Euro janë shtesa. Këto shtesa përbëjnë rreth 32% të rrogës së tyre mujore. Në deklarinmet e pasurisë të vitit 2020 të ardhurat mesatare ishin 1783 Euro në muaj dhe shtesat mesatare 550 Euro në muaj. Në deklarinmet e pasurisë të vitit 2019 të ardhurat mesatare mujore ishin 1618 Euro, prej të cilave 542 Euro ishin shtesa.

SHTESAT PËRGJATË VITEVE SIPAS POZITAVE - UNIVERSITETI I PRIZRENIT



Asnjë nga profesorët nuk i ka shtesat më të larta se rroga bazë.

*Fondi për shkencë

Nuk ka informata publike për shpenzimet e paguara për këtë kategori për vitin 2020, mirëpo në përgjigjet zyrtare të pranuar nga UPZ, thuhet se buxheti i shpenzuar gjatë vitit 2020 për kontributin ndaj shkencës kap shumën totale prej 3 mijë e 531 Euro derisa të planifikuara ishin 25 mijë Euro, ndërkohë që shuma e planifikuar për vitin 2021 është 5 mijë Euro.

Për krahasim, sa i përket shpenzimeve për botimin e publikimeve, në vitin 2019 UPZ kishte deklaruar se kanë shpenzuar vetëm 2 mijë Euro.

*Bursa për studentë

Nuk ka informata publike për shpenzimet e paguara për këtë kategori për vitin 2020, mirëpo në përgjigjet zyrtare të pranuar nga UPZ, thuhet se shuma e mjeteve të shpenzuara për bursa të studentëve në vitin 2020 ishte 99 mijë e 985 Euro. UPZ kishte ndarë 153 bursa me shumën prej 653 Euro për student. Ndërsa 100 mijë Euro janë të planifikuara për vitin 2021.

Për krahasim, gjatë vitit 2019 sipas UPZ-së ishin ndarë gjithsej 68 mijë e 805 Euro për 154 studentë me shumën prej 446 Euro.



Të dhënat e detajuara sipas deklarimeve të pasurisë të vitit 2021, me shumën që paraqesin të ardhurat vjetore të pjesëtuara për 12 muaj mund t'i gjeni në **aneksin numër 2.**

		2019	2020	2021
Mesatarja e të ardhurave mujore	Këshilli Drejtues	1604 €	1915 €	1,687 €
	Rektorati	2199 €	2080 €	2,064 €
	Dekanët	2120 €	2208 €	1,911 €
	Prodekanët	1618 €	1783 €	1,828 €
Mesatarja e shtesave	Këshilli Drejtues	394 €	733 €	504 €
	Rektorati	989 €	860 €	805 €
	Dekanët	861 €	873 €	637 €
	Prodekanët	452 €	550 €	594 €
Minimumi dhe maksimumi i të ardhurave mujore	Këshilli Drejtues	1446 €, 1888 €	1483 €, 2260 €	1,399 €, 1,942 €
	Rektorati	1854 €, 2551 €	1738 €, 2738 €	1,778 €, 2,323 €
	Dekanët	1500 €, 2817 €	2024 €, 2398 €	1,480 €, 2,289 €
	Prodekanët	1374 €, 2010 €	1350 €, 2217 €	1,458 €, 2,284 €
Minimumi dhe maksimumi i shtesave	Këshilli Drejtues	17 €, 751 €	301 €, 1077 €	217 €, 760 €
	Rektorati	717 €, 1268 €	556 €, 1403 €	507 €, 1,131 €
	Dekanët	217 €, 1534 €	689 €, 1063 €	297 €, 954 €
	Prodekanët	237 €, 873 €	167 €, 882 €	275 €, 950 €



Të planifikuara me buxhetin e vitit 2021 janë **180 mijë Euro**, mirëpo nuk ka të dhëna publike që tregojnë për numrin, llojin apo shpenzimet për projektet me investime kapitale.

***Investimet kryesore kapitale**

Nuk ka informata publike për shpenzimet e paguara për këtë kategori për vitin 2020, mirëpo në përgjigjet zyrtare të pranuar nga UPZ, thuhet se investimet kapitale të realizuara kapin shumën prej 90 mijë e 414 Euro nga Buxheti i Kosovës, ndërsa 13 mijë e 800 Euro nga donacionet. Të planifikuara me buxhetin e vitit 2021 janë 180 mijë Euro, mirëpo nuk ka të dhëna publike që tregojnë për numrin, llojin apo shpenzimet për projektet me investime kapitale.

Për krahasim, gjatë vitit 2019 ishin shpenzuar gjithsej 44 mijë e 900 Euro në pajisje laboratorike, ndërkohë që për vitin 2020, ishin planifikuar të shpenzohen 200 mijë Euro.

***Sigurimi fizik i objekteve**

Nuk ka informata publike për shpenzimet e paguara për këtë kategori për vitin 2020, mirëpo në përgjigjet zyrtare të pranuar nga UPZ, thuhet se shuma e shpenzuar për sigurim fizik të objekteve gjatë vitit 2020 ishte 33 mijë e 674 Euro, ndërsa shuma e planifikuar për vitin 2021 është 35 mijë Euro.

Për krahasim, sipas UPZ-së gjatë vitit 2019 ishin shpenzuar gjithsej 31 mijë e 735 Euro dhe për vitin 2020, ishin planifikuar 35 mijë Euro.

***Shpenzimet gjyqësore**

Nuk ka informata publike për shpenzimet e paguara për këtë kategori për vitin 2020, mirëpo në përgjigjet zyrtare të pranuar nga UPZ, thuhet se nuk është paguar ndonjë shumë për shpenzime gjyqësore ndërkohë që për këtë kategori gjatë vitit 2019 ishin shpenzuar gjithsej 654 Euro.

Të gjetura nga Auditori

Në Raportin e Auditimit për MASHTI-në për vitin 2020³⁶, është përsëritur gjetja e vitit të kaluar se si katër nga gjashtë universitetet publike me aprovime të këshillave drejtuese kishin përfshirë në rregullore, kompensime shtesë për pjesëmarrje në disa lloje të komisioneve që konsiderohen si jostatutare dhe në kundërshtim me kërkesat ligjore, ku mes tyre gjendet edhe Universiteti i Prizrenit.

³⁶ Raporti i Auditimit për pasqyrat financiar të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për vitin 2020, linku: https://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2021/07/RaportiAuditimit_MASHTI_2020_Shqip.pdf

Sipas këtij raporti, Ligji për menaxhimin e financave publike³⁷ nuk lejon kompensimin shtesë nëse një punonjës, shërbyes civil ose zyrtar i një autoriteti publik sipas një akti të Qeverisë kërkohet që të shërbejë në një komision, bord ose autoritet tjetër publik. Meqenëse shërbimi konsiderohet pjesë e detyrave të obligueshme të postit të cilin e mban punonjësi. Universiteti i Prizrenit kishte shpenzuar shumën prej 27 mijë e 650 Euro për këto kompensime.

Punonjësit e UPZ-së gjithashtu ishin kompensuar për pjesëmarrje në komisionin për inventarizimin e pasurive, pranimin e studentëve të rinj, për ankesa dhe parashtresa, rekrutim të stafit, komisioni për pranimin e donacioneve, për vlerësimin e ofertave, derisa takimet i kishin mbajtur gjatë orarit të rregullt të punës. Vlera e kompensimeve shtesë për anëtarët e komisionit për muajin tetor, nëntor dhe dhjetor ishte 3 mijë e 780 Euro.

Universiteti i Prizrenit me vendim të Këshillit Drejtues me 3 nëntor 2020, kishte bërë plotësimin dhe ndryshimin e rregullores, mirëpo nuk kishte shfuqizuar të gjitha nenet të cilat parashohin kompensimet e komisioneve.

Tutje në raport ishte deklaruar se përkundër rekomandimit nga viti i kaluar, ky universitet ende nuk ka ndërmarrë veprime për plotësim ndryshimin e rregulloreve për kompensimin e komisioneve të brendshme.

“Universiteti i Prizrenit me vendim të KD me datën 03.11.2020, kishte bërë plotësimin dhe ndryshimin e rregullores, mirëpo nuk kishte shfuqizuar të gjitha nenet të cilat parashohin kompensimet e komisioneve. Vlera e kompensimeve shtesë për anëtarët e komisionit për muajin tetor, nëntor dhe dhjetor ishte 3,780€.”³⁸, thuhet në raportin e auditimit.



Nuk ka informata publike për shpenzimet e paguara për këtë kategori për vitin 2020, mirëpo në përgjigjet zyrtare të pranuar nga UPZ, thuhet se shuma e shpenzuar për sigurim fizik të objekteve gjatë vitit 2020 ishte **33 mijë e 674 Euro**, ndërsa shuma e planifikuar për vitin 2021 është **35 mijë Euro**.

37 Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, 2008, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2524>

38 Raporti i Auditimit për pasqyrat financiar të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për vitin 2020”, fq. 25, linku: https://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2021/07/RaportiAuditimit_MASHTI_2020_Shqip.pdf



UNIVERSITETI I PEJËS

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës³⁹, Universiteti i Pejës (UHZ), për vitin akademik 2020-2021 ka gjithsej 80 punonjës akademik të rregullt, prej tyre 25 gra dhe 55 burra, si dhe 114 të angazhuar, prej tyre 39 gra dhe 75 burra. Krahasuar me vitin akademik 2019/2020, UHZ kishte gjithsej 70 punonjës akademik të rregullt, prej tyre 30 gra dhe 53 burra, si dhe 40 të angazhuar, prej tyre 9 gra dhe 55 burra.

Universiteti i Pejës, në nivelin Bachelor ka gjithsej 7 mijë e 772 studentë, në nivelin Master ka gjithsej 1 mijë e 193 student, ndërsa nivelin e doktoratës nuk e ka.

Numri i studentëve në Universitetin e Pejës

	BA			MA			PhD		
			Gjithsej			Gjithsej			Gjithsej
2019/20	3,916	5,697	9,613	840	630	1,470	-	-	-
2020/21	2,867	4,905	7,772	635	558	1,193	-	-	-

Raporti student-mësimdhënës në Universitetin e Pejës në vitin 2020 del të jetë 112:1.

³⁹ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e arsimit në Kosovë 2020/21, fq. 17, linku: <https://ask.rks-gov.net/media/6072/statistikat-e-arsimit-20202021.pdf>

Numri i të diplomuarve në Universitetin e Pejës

	BA			MA		
			Gjithsej			Gjithsej
2018/19	276	143	419	128	73	201
2019/20	191	120	311	134	69	203

Analiza e shpenzimeve

Nga thesari i buxhetit të Kosovës, për Universitetin e Pejës, ishin ndarë gjithsej 3 milionë e 62 mijë e 664 Euro për vitin 2020⁴⁰, ndërsa ishin shpenzuar 3 milionë e 760 mijë e 132 Euro. Kurse për vitin 2021, është ndarë apo planifikuar të shpenzohet shuma e njëjtë prej 3 milionë e 459 mijë e 753 Euro.

Për krahasim, në vitin 2019 nga buxheti i Kosovës⁴¹ ishin shpenzuar gjithsej 3 milionë e 380 mijë e 544 Euro.

46% për këtë universitet për vitin 2020, është shpenzuar për paga dhe mëditje të stafit akademik, me 1 milionë e 727 mijë e 717 Euro, të parapara për 162 të punësuar. Krahasuar me vitin 2019, kur për paga dhe mëditje ishin shpenzuar 1 milionë e 848 mijë e 129 Euro, rezulton se kjo shumë ka rënë për mbi 120 mijë Euro. Ndërkaq për vitin 2021, janë ndarë 1 milionë e 656 mijë e 746 Euro⁴².

40 Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, linku: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/23991BEA-4CD9-40B3-94D3-EA192C572464.pdf>

41 Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, linku: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/4CEFBA4C-4397-4901-AB93-2AA37F43A9F7.pdf>

42 Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, linku: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/5EA509E4-2933-4524-BD0F-5466A661486F.pdf>



LINJA BUXHETORE PËR UNIVERSITETIN E PEJËS 2019, 2020 DHE 2021

Pagat dhe mëditjet	2019	1,848,129	55%
	2020	1,727,717	46%
	2021	1,656,746	62%
Mallrat dhe shërbimet	2019	412,007	12%
	2020	412,007	11%
	2021	500,000	19%
Shpenzimet komunale	2019	50,408	1%
	2020	50,408	1%
	2021	50,408	2%
Subvencionet dhe transferet	2019	100,000	3%
	2020	100,000	3%
	2021	100,000	4%
Shpenzimet kapitale	2019	970,000	29%
	2020	1,470,000	39%
	2021	350,000	13%
Total Shpenzimet	2019	3,380,544	100%
	2020	3,760,132	
	2021	2,657,154	

Për mallra dhe shërbime, UHZ kishte shpenzuar 412 mijë Euro gjatë vitit 2020, ndërkohë që edhe gjatë vitit 2019, ishte shpenzuar shuma e njëjtë. Kurse për vitin 2021, është ndarë shuma prej 500 mijë Euro.

Për shpenzime komunale gjatë vitit 2020, janë shpenzuar 50 mijë e 408 Euro, ndërkaj gjatë vitit 2019, ishte shpenzuar shuma e njëjtë, si dhe është planifikuar e njëjta për vitin 2021. Shuma e shpenzuar dhe e ndarë për subvencione dhe transfere në UHZ, përgjatë viteve 2021, 2020 dhe 2019 nuk ka ndryshuar, pra është nga 100 mijë Euro.

Buxheti për shpenzime kapitale për vitin 2020 ishte 1 milionë e 470 mijë Euro, për krahasim me vitin 2019 kur ishin shpenzuar gjithsej 970 mijë Euro. Kurse për vitin 2021, janë ndarë 350 mijë Euro.

Shpenzimet për studentë në vitin 2021 janë 256 Euro për kokë studenti. Për krahasim, vitin e kaluar kanë qenë 320 Euro.

Shumës së përgjithshme të buxhetit të ndarë nga Qeveria e Kosovës, UHZ i kishte shtuar edhe 105 mijë Euro nga të hyrat vetanake, sipas ligjit mbi ndarjet buxhetore për vitin 2020.

Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Pejës

Pagat e profesorëve dhe shtesat në Universitetin e Pejës janë të rregulluara përmes Rregullores të datës 08.03.2018 për të ardhurat personale, shtesat funksionale dhe honoraret të personelit akademik në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë.⁴³

Neni 7 i kësaj rregullore, përcakton kompensimin e personelit akademik me normë të plotë, sipas kësaj tablele:

Titulli	Orë në javë	Paga mujore
Profesorët e rregullt	 6	1429.54 Euro
Profesorët e asocuar	 6	1283.34 Euro
Profesorët asistent	 6	1137.14 Euro
Lektorët/Korepetitorët	 10	844.73 Euro
Asistentët	 10	772.50 Euro

Tabela 1. Pagat bazë të personelit akademik në Universitetin e Pejës

Po ashtu, përtej pagës bazë, stafi akademik i cili ushtron detyra menaxheriale në kuadër të Universitetit të Pejës, kompensohet sipas kësaj tablele:

Pozita	Shtesa
Rektor	600 Euro
Prorektor	400 Euro
Dekan	300 Euro
Prodekan	200 Euro

Tabela 2. Shtesat për pozita menaxheriale në Universitetin e Pejës

Personeli akademik në Universitet të Pejës ka të drejtë të angazhohet në orë shtesë (mbi-norma) deri në 6 orë në javë (profesorët) dhe deri në 8 orë në javë (lektorët, asistentët). Këto orë shtesë kompensohen sipas kësaj tablele:

⁴³ Rregullorja për të ardhurat personale, shtesat funksionale dhe honoraret të personelit akademik në Universitetin «Haxhi Zeka» në Pejë. 08.03.2018 Link: <https://drive.google.com/file/d/1DsiA4YBmLMDqAwKU3di2gFP6CV4B-5Fq/view>

Titulli	Shtesa
Profesorë (të rregullt, të asocuar dhe asistent)	30 Euro
Lektor, asistent	15 Euro

Tabela 3. Kompensimet e mbi-normës

Personeli akademik po ashtu kompensohet për mentorimin e temave të diplomës si dhe për pjesëmarrjen në komisione të vlerësimit të temës së diplomës, në nivelet BA, MA dhe PhD.


Komisioni	BA	MA	PHD
Mentori	30 Euro	150 Euro	1000 Euro
Kryetari i komisionit	n/a	70 Euro	300 Euro
Anëtar i komisionit	10 Euro	60 Euro	250 Euro

Tabela 4. Kompensimet e mentorimeve të temave të diplomës

Analiza e të dhënave nga deklaratimet e pasurisë

Në analizën e deklaratave të pasurisë për Universitetin e Pejës janë përfshirë anëtarët e Këshillit Drejtues (vetëm anëtarët me titull akademik), rektori, prorektorët, dekanët dhe prodekanët.


SHTESAT E STAFIT MENAXHERIAL NË UNIVERSITETIN E PEJËS NDËR VITE



Në përgjithësi të ardhurat mujore të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Pejës kanë pasur rënie graduale nga viti në vit por prapë se prapë janë të larta. Derisa në vitin 2019 mesatarja e të ardhurave mujore ishte 2 mijë e 103 Euro, në vitin 2020 kjo shumë është zbritur në 2 mijë e 57 Euro, ndërsa në vitin 2021 ka rënë në 1 mijë e 976 Euro.

Ndërkaq shtesat mujore gjithashtu kanë pasur ndryshimet e ngjashme, nga 888 Euro sa ishin në vitin 2019, në 835 Euro gjatë vitit 2020 dhe tani mesatarja ka rënë në 741 Euro.

TË ARDHURAT MUJORE PËRGJATË VITEVE SIPAS POZITAVE - UNIVERSITETI I PEJËS



Anëtarët e Këshillit Drejtues me titull akademik mesatarisht paguhen 1452 Euro në muaj nga buxheti i Universitetit, ku mesatarisht ata marrin 509 Euro në muaj në shtesa. Këto shtesa përbëjnë rreth 35% të rrogës së tyre mujore. Këto shifra tregojnë për një rritje të shtesave krahasuar me deklarinimet e pasurisë të vitit 2020 ku të ardhurat mesatare ishin 1400 Euro në muaj dhe shtesat mesatare 385 Euro në muaj. Në deklarinimet e pasurisë të vitit 2019, të ardhurat mesatare mujore ishin 1407 Euro në muaj, prej tyre mesatarisht 343 Euro shtesa.


Anëtarët e Rektoratit mesatarisht paguhen 2402 Euro në muaj nga buxheti i universitetit, ku 1009 Euro janë shtesa. Këto shtesa përbëjnë rreth 42% të rrogës së tyre mujore. Ka rënie të shtesave nga deklarinimet e pasurisë të vitit 2020 ku të ardhurat mesatare ishin 2428 Euro dhe shtesat mesatare 1108 Euro në muaj. Të ardhura të ngjashme kishe edhe në deklarinimet e pasurisë të vitit 2019, me mesatarisht 2397 Euro në muaj, prej tyre 1110 Euro shtesa.

Dekanët e fakulteteve mesatarisht paguhen 2184 Euro në muaj nga buxheti i universitetit, ku 901 Euro janë shtesa. Këto shtesa përbëjnë rreth 41% të rrogës së tyre mujore. Këto

shifra tregojnë për një zvogëlim të shtesave krahasuar me deklarinimet e pasurisë së vitit 2020 ku të ardhurat mesatare ishin 2320 Euro në muaj dhe shtesat mesatare 1037 Euro në muaj. Në 2019 mesatarja e të ardhurave ishte 2145 Euro në muaj dhe e shtesave 978 Euro në muaj.

Prodekanët e fakulteteve mesatarisht paguhën 1735 Euro në muaj nga buxheti i universitetit, ku 488 Euro janë shtesa. Këto shtesa përbëjnë rreth 28% të rrogës së tyre mujore. Ka zvogëlim të shtesave krahasuar me deklarinimet e pasurisë të vitit 2020 ku të ardhurat mesatare ishin 1977 Euro në muaj dhe shtesat mesatare 756 Euro në muaj. Në deklarinimet e pasurisë të vitit 2019 të ardhurat mesatare mujore ishin 1995 Euro, prej të cilave 785 Euro ishin shtesa.

SHTESAT PËRGJATË VITEVE SIPAS POZITAVE - UNIVERSITETI I PEJËS



Asnjë nga profesorët nuk i ka shtesat më të larta se rroga bazë.

*Fondi për shkencë

Gjatë vitit 2020, UHZ ka shpenzuar 5 mijë e 339 Euro për pjesëmarrje në konferenca, projekte kërkimore/hulumtuese, punimet më të mira dhe shpenzime të tjera për organizim të konferencave. Planifikimi për vitin 2021, është 67 mijë e 500 Euro. Për krahasim, gjatë vitit 2019 ishin shpenzuar gjithsej 17 mijë e 473 Euro për kërkime shkencore, ndërkohë që planifikimi për shpenzime në këtë kategori gjatë vitit 2020, ishte 50 mijë Euro.

*Bursa për studentë

Universiteti i Pejës, gjatë vitit 2020 ka ndarë gjithsej 43 bursa⁴⁴ për studentë të dalluar në vlerë prej 950 Euro për student, pra janë shpenzuar gjithsej 40 mijë e 850 Euro. Ndërkohë që për vitin 2021, janë planifikuar të shpenzohen 50 mijë Euro.

⁴⁴ Vendimet mbi ndarjen e bursave universitare për vitin akademik 2020/2021, linqet: <https://drive.google.com/file/d/15rFDQXJ49dXC09tUDEcpyzf-bWH1ofnVU/view>, https://drive.google.com/file/d/lu_Z6E16p50x5e16xEyuculqXJ1oVwQpH/view



Të dhënat e detajuara sipas deklarimeve të pasurisë të vitit 2021, me shumatat që paraqesin të ardhurat vjetore të pjesëtuara për 12 muaj mund t'i gjeni në **aneksin numër 3.**

		2019	2020	2021
Mesatarja e të ardhurave mujore	Këshilli Drejtues	1407 €	1404 €	1,452 €
	Rektorati	2397 €	2428 €	2,402 €
	Dekanët	2145 €	2320 €	2,184 €
	Prodekanët	1995 €	1977 €	1,735 €
Mesatarja e shtesave	Këshilli Drejtues	343 €	385 €	509 €
	Rektorati	1110 €	1108 €	1,009 €
	Dekanët	978 €	1037 €	901 €
	Prodekanët	785 €	756 €	488 €
Minimumi dhe maksimumi i të ardhurave mujore	Këshilli Drejtues	756 €, 2166 €	1210 €, 1600 €	981 €, 2,003 €
	Rektorati	1684 €, 2827 €	1874 €, 2828 €	2,235 €, 2,554 €
	Dekanët	1792 €, 2710 €	1794 €, 2677 €	1,977 €, 2,383 €
	Prodekanët	1612 €, 2561 €	1391 €, 2725 €	1,361 €, 1,974 €
Minimumi dhe maksimumi i shtesave	Këshilli Drejtues	0, 883 €	254 €, 462 €	936 €, 1,124 €
	Rektorati	547 €, 1398 €	591 €, 1545 €	936 €, 1,124 €
	Dekanët	655 €, 1573 €	511 €, 1393 €	694 €, 1,099 €
	Prodekanët	392 €, 1424 €	245 €, 1588 €	224 €, 691 €



Investimet kapitale gjatë vitit 2020 ishin **542 mijë e 893 Euro**, kurse në vitin 2021 në këtë kategori, UHZ ka të planifikuara **350 mijë Euro**.

Për krahasim, në vitin akademik 2019/2020, shuma totale e shpenzuar për bursa ka qenë 64 mijë e 800 Euro, prej të cilës kishin përfituar gjithsej 72 studentë nga 900 Euro. Ndërsa shuma e planifikuar për vitin akademik 2020/2021, ishte 50 mijë Euro.

***Investimet kryesore kapitale**

Investimet kapitale gjatë vitit 2020 ishin 542 mijë e 893 Euro⁴⁵, kurse në vitin 2021 në këtë kategori, UHZ ka të planifikuara 350 mijë Euro. Gjatë vitit 2020, Universiteti i Pejës ka investuar më së shumti për këto tri projekte: 'Ndërtimi dhe renovimi i infrastrukturës në UHZ', në vitin 2017 UHZ-ja ka filluar ndërtimin e objektit për Fakultetin e Artëve me sipërfaqe prej 5000 m², prandaj gjatë vitit 2020 ka vazhduar ndërtimi i fazës së tretë dhe fazës së katërt për të cilën janë shpenzuar 516 mijë e 643 Euro; 'Blerja e pajisjeve për UHZ -në', është bërë furnizimi me pajisje të nevojshme për studentët e Fakultetit të Artëve në vlerë prej 15 mijë e 865 Euro, ndërsa për pajisje të tjera 2 mijë e 885 Euro, gjithsej 18 mijë e 750 Euro; 'Blerja e pajisjeve laboratorike dhe të IT - së', UHZ është furnizuar me pajisje në vlerë prej 7 mijë e 500 Euro.

Për krahasim, në vitin 2019, UHZ kishte shpenzuar 662 mijë e 347 Euro për këto projekte kapitale; ndërtim dhe renovim i infrastrukturës së UHZ-së në të cilin ishin shpenzuar 609 mijë e 363 Euro, blerja e pajisjeve për UHZ-në në të cilin ishin shpenzuar 33 mijë e 527 Euro, si dhe blerja e pajisjeve laboratorike për UHZ-në në të cilin ishin shpenzuar 19 mijë e 457 Euro. Ndërkaq ishin ndarë gjithsej 1 milionë e 102 mijë e 500 Euro për vitin 2020, për këto projekte; ndërtim dhe renovim i infrastrukturës me shumën prej 1 milionë e 50 mijë Euro, pajisje tjera me shumën prej 37 mijë e 500 Euro, si dhe pajisje laboratorike me shumën prej 15 mijë Euro.

⁴⁵ Raporti Vjetor i Punës së UHZ-së në Pejë për vitin 2020, fq.34, linku: <https://drive.google.com/file/d/19gKLeGGc4XDE3MnqxPL0mw0IYxGrWf-t/view>

*Sigurimi fizik i objekteve

Sipas Raportit Vjetor për vitin 2020, Universiteti i Pejës ka shpenzuar gjithsej 54 mijë e 218 Euro për sigurimin e ndërtesave, ndërsa për vitin 2021 ka planifikuar që t'i shpenzojë 60 mijë Euro.

Për krahasim, në vitin 2019 ishin shpenzuar 58 mijë e 147 Euro. Ndërkohë që për vitin 2020 ishin planifikuar të shpenzohen 59 mijë e 147 Euro.

*Shpenzimet gjyqësore

Në Raportin Vjetor të Punës së Universitetit të Pejës⁴⁶ nuk ka të shënuar ndonjë shumë të paguar për shpenzime apo pagesa për vendime gjyqësore, mirëpo në përgjigjet e UHZ-së përmes adresës elektronike thuhet se kanë shpenzuar gjithsej 1 mijë e 440 Euro për vendime gjyqësore gjatë vitit 2020. Ndërkaq për krahasim me vitin 2019, UHZ nuk kishte paguar për shpenzime gjyqësore.

Të gjetura nga Auditori

Në Raportin e Auditimit për MASHTI-në për vitin 2020⁴⁷, nuk ka ndonjë të gjetur rreth pagesave të stafit akademik mirëpo ka gjetje rreth disa pagesave për të cilat janë bërë ndryshime tek shpenzimet kapitale por pa ndryshuar shuma totale. Rekomandimi i auditorit ka qenë që rektori i Universitetit të Pejës duhet të parandalojë rastet e ngjashme ku pozicionet e punimeve ndryshohen pa aprovime paraprake siç kërkohen me rregulla dhe procedura të prokurimit. Gjithashtu është dhënë një tender për furnizim me pajisje të IT-së por pa i respektuar kriteret e plota të përcaktuara në dosjen e tenderit.



Sipas Raportit Vjetor për vitin 2020, Universiteti i Pejës ka shpenzuar gjithsej **54 mijë e 218 Euro** për sigurimin e ndërtesave, ndërsa për vitin 2021 ka planifikuar që t'i shpenzojë **60 mijë Euro**.

⁴⁶ Raporti Vjetor i Punës së UHZ-së në Pejë për vitin 2020, fq.36, linku: <https://drive.google.com/file/d/19gKLeGGc4XDE3MngxPL0mw0IYxGrWf-t/view>

⁴⁷ Raporti i Auditimit për pasqyrat financiar të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për vitin 2020, linku: https://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2021/07/RaportiAuditimit_MASHTI_2020_Shqip.pdf



UNIVERSITETI I GJAKOVËS

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës⁴⁸, Universiteti i Gjakovës (UGJFA), për vitin akademik 2020-2021 ka gjithsej 56 punonjës akademik të rregullt, prej tyre 26 gra dhe 30 burra, si dhe 52 të angazhuar, prej tyre 23 gra dhe 29 burra. Krahasuar me vitin akademik 2019/2020, UGJFA kishte gjithsej 50 punonjës akademik të rregullt, prej tyre 22 gra dhe 28 burra, si dhe 32 të angazhuar, prej tyre 14 gra dhe 18 burra.

Universiteti i Gjakovës, në nivelin Bachelor në vitin 2020 ka gjithsej 1 mijë e 517 studentë. Në nivelin e studimeve Master nuk ka studentë dhe nivelin e studimeve të doktoratës nuk e ka.

Numri i studentëve në Universitetin e Gjakovës

	BA			MA			PhD		
			Gjithsej			Gjithsej			Gjithsej
2019/20	1,399	254	1,653	-	-	-	-	-	-
2020/21	1,303	214	1,517	-	-	-	-	-	-

Raporti student-mësimdhënës në Universitetin e Gjakovës për këtë periudhë del të jetë 27:1.

⁴⁸ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e arsimit në Kosovë 2020/21, fq. 84, linku: <https://ask.rks-gov.net/media/6072/statistikat-e-arsimit-20202021.pdf>

Numri i të diplomuarve në Universitetin e Gjakovës

	BA			MA		
			Gjithsej			Gjithsej
2018/19	318	63	381	-	-	-
2019/20	128	18	146	-	-	-

Analiza e shpenzimeve

Nga thesari i buxhetit të Kosovës, për Universitetin e Gjakovës, ishin ndarë gjithsej 2 milionë e 447 mijë e 605 Euro për vitin 2020⁴⁹, ndërsa ishin shpenzuar 2 milionë e 301 mijë e 167 Euro. Kurse për vitin 2021, është ndarë apo planifikuar të shpenzohet shuma prej 2 milionë e 501 mijë e 167 Euro.

Për krahasim, në vitin 2019 nga buxheti i Kosovës⁵⁰ ishin shpenzuar gjithsej 2 milionë e 401 mijë e 167 Euro.

51% e buxhetit për këtë universitet për vitin 2020, është shpenzuar për paga dhe mëditje të stafit akademik, me 1 milionë e 184 mijë e 828 Euro, të parapara për 111 të punësuar. Krahasuar me vitin 2019, kur për paga dhe mëditje ishte shpenzuar shuma e njëjtë prej 1 milionë e 184 mijë e 828 Euro. Ndërkaq për vitin 2021, janë ndarë 2 milionë e 501 mijë e 167 Euro.

Për mallra dhe shërbime, UGJFA kishte shpenzuar 316 mijë e 339 Euro gjatë vitit 2020, ndërkohë që edhe gjatë vitit 2019, ishte shpenzuar shuma e njëjtë. Kurse për vitin 2021, është ndarë shuma prej 400 mijë Euro⁵¹.

49 Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, linku: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/23991BEA-4CD9-40B3-94D3-EA192C572464.pdf>

50 Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, linku: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/4CEFBA4C-4397-4901-AB93-2AA37F43A9F7.pdf>

51 Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, linku: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/5EA509E4-2933-4524-BD0F-5466A661486F.pdf>



LINJA BUXHETORE PËR UNIVERSITETIN E GJAKOVËS 2019, 2020 DHE 2021

Pagat dhe mëditjet	2019	1,844,828	77%
	2020	1,184,828	51%
	2021	1,181,477	55%
Mallrat dhe shërbimet	2019	316,339	13%
	2020	316,339	14%
	2021	400,000	19%
Shpenzimet komunale	2019	50,000	2%
	2020	50,000	2%
	2021	50,000	2%
Subvencionet dhe transferet	2019	100,000	4%
	2020	100,000	4%
	2021	100,000	5%
Shpenzimet kapitale	2019	750,000	31%
	2020	650,000	28%
	2021	400,000	19%
Total Shpenzimet	2019	2,401,167	100%
	2020	2,301,167	
	2021	2,131,477	

Për shpenzime komunale gjatë vitit 2020, janë shpenzuar 50 mijë Euro, ndërkaj gjatë vitit 2019, ishte shpenzuar shuma e njëjtë, si dhe është planifikuar e njëjta për vitin 2021. Shuma e shpenzuar dhe e ndarë për subvencione dhe transfere në UGJFA, përgjatë viteve 2021, 2020 dhe 2019 nuk ka ndryshuar, pra është nga 100 mijë Euro.

Buxheti për shpenzime kapitale për vitin 2020 ishte 650 mijë Euro, për krahasim me vitin 2019 kur ishin shpenzuar gjithsej 750 mijë Euro. Kurse për vitin 2021, janë ndarë 400 mijë Euro.

Shpenzimet për studentë në vitin 2021 janë 1387 Euro për kokë studenti. Për krahasim, vitin e kaluar kanë qenë 1 mijë e 195 Euro.

Shumës së përgjithshme të buxhetit të ndarë nga Qeveria e Kosovës, UGJFA i kishte shtuar edhe 58 mijë e 879 Euro nga të hyrat vetanake, sipas ligjit mbi ndarjet buxhetore për vitin 2020.

Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Gjakovës

Pagat e profesorëve dhe shtesat në Universitetin e Gjakovës janë të rregulluara përmes Rregullores për të ardhura personale në Universitetin Publik në Gjakovë.⁵²

Neni 8 i kësaj rregullore, përcakton kompensimin e personelit akademik me normë të plotë, sipas kësaj tablele:

Titulli	Orë në javë	Paga mujore
Profesorët e rregullt	 6	1484.72 Euro
Profesorët e asocuar	 6	1334.67 Euro
Profesorët asistent	 6	1182.62 Euro
Ligjëruesit	 6	1030.57 Euro
Lektorët	 10	878.52 Euro
Asistentët	 10	878.52 Euro
Asistent i ri	 10	726.70 Euro

Tabela 1. Pagat bazë të personelit akademik në Universitetin e Gjakovës

Po ashtu, përtej pagës bazë, stafi akademik i cili ushtron detyra menaxheriale në kuadër të Universitetit të Gjakovës, kompensohet sipas kësaj tablele:

Pozita	Shtesa
Rektor	500 Euro
Prorektor	450 Euro
Dekan	350 Euro
Prodekan	250 Euro

Tabela 2. Shtesat për pozita menaxheriale në Universitetin e Gjakovës

⁵² 18. Rregullorja për të Ardhura Personale të personelit akademik, shtesat për funksione, honoraret dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Gjakovës "Fehmi Agani". 21.10.2019. Link: <https://uni-gjk.org/upload/dokumentet/42253-Rregullore%20per%20te%20ardhurat%20personale%20ne%20upgj.pdf>

Personeli akademik në Universitet të Gjakovës ka të drejtë të angazhohet në orë shtesë (mbi-norma) deri në 5 orë në javë (profesorët) dhe deri në 8 orë në javë (lektorët, asistentët). Këto orë shtesë kompensohen sipas kësaj tablele:

Titulli	Shtesa
Profesorë (të rregullt, të asocuar dhe asistent)	25 Euro
Ligjërues, lektor, asistent	13 Euro

Tabela 3. Kompensimet e mbi-normës

Personeli akademik po ashtu kompensohet për mentorimin e temave të diplomës si dhe për pjesëmarrjen në komisione të vlerësimit të temës së diplomës, në nivelet BA, MA dhe PhD.


Komisioni	BA	MA	PHD
Mentori	20 Euro	150 Euro	1200 Euro
Kryetari i komisionit	n/a	50 Euro	300 Euro
Anëtar i komisionit	10 Euro	30 Euro	200 Euro

Tabela 4. Kompensimet e mentorimeve të temave të diplomës

Analiza e të dhënave nga deklaratimet e pasurisë

Në analizën e deklaratave të pasurisë për Universitetin e Gjakovës janë përfshirë anëtarët e Këshillit Drejtues (vetëm anëtarët me titull akademik), rektori, prorektorët, dekanët dhe prodekanët.


SHTESAT E STAFIT MENAXHERIAL NË UNIVERSITETIN E GJAKOVËS NDËR VITE



Në përgjithësi të ardhurat mujore të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Gjakovës kanë pasur rënie graduale në dy vitet e fundit mirëpo këtë vit janë rritur. Derisa në vitin 2019 mesatarja e të ardhurave mujore ishte 2 mijë e 23 Euro, në vitin 2020 kjo shumë është zbritur në 1 mijë e 879 Euro, ndërsa në vitin 2021 është rritur më shumë se gjatë vitit 2019 pra në 2 mijë e 26 Euro.

Ndërkaq shtesat mujore gjithashtu kanë pasur ndryshimet e ngjashme, nga 1 mijë e 58 Euro sa ishin në vitin 2019, në 668 Euro gjatë vitit 2020 dhe tani mesatarja është rritur në 786 Euro.

TË ARDHURAT MUJORE PËRGJATË VITEVE SIPAS POZITAVE - UNIVERSITETI I GJAKOVËS




Anëtarët e Këshillit Drejtues me titull akademik mesatarisht paguhën 1724 Euro në muaj nga buxheti i Universitetit, ku mesatarisht ata marrin 522 Euro në muaj në shtesa. Këto shtesa përbëjnë rreth 30% të rrogës së tyre mujore. Shifra të ngjashme ishin edhe në deklarinimet e pasurisë të vitit 2020 ku të ardhurat mesatare ishin 1707 Euro në muaj dhe shtesat mesatare 551 Euro në muaj. Në deklarinimet e pasurisë të vitit 2019, të ardhurat mesatare mujore ishin 1407 Euro në muaj, prej tyre mesatarisht 553 Euro shtesa.

Anëtarët e Rektoratit mesatarisht paguhën 2401 Euro në muaj nga buxheti i universitetit, ku 1168 Euro janë shtesa. Këto shtesa përbëjnë rreth 49% të rrogës së tyre mujore. Ka rritje nga deklarinimet e pasurisë të vitit 2020 ku të ardhurat mesatare ishin 2,092 Euro dhe shtesat mesatare 882 Euro në muaj. Të ardhura të larta kishte edhe në deklarinimet e pasurisë të vitit 2019, me mesatarisht 2346 Euro në muaj, prej tyre 1359 Euro shtesa.

Dekanët e fakulteteve mesatarisht paguhën 2234 Euro në muaj nga buxheti i universitetit, ku 899 Euro janë shtesa. Këto shtesa përbëjnë rreth 40% të rrogës së tyre mujore. Shifra të ngjashme janë edhe në deklarinimet e pasurisë të vitit 2020 ku të ardhurat mesatare ishin 2224 Euro në muaj dhe shtesat mesatare 892 Euro në muaj. Në vitin 2019 ku mesatarja e të ardhurave ishte 2149 Euro në muaj dhe e shtesave 1454 Euro në muaj.

Prodekanët e fakulteteve mesatarisht paguhën 1756 Euro në muaj nga buxheti i universitetit, ku 573 Euro janë shtesa. Këto shtesa përbëjnë rreth 33% të rrogës së tyre mujore. Ka rritje të shtesave krahasuar me deklarinimet e pasurisë të vitit 2020 ku të ardhurat mesatare ishin 1278 Euro në muaj dhe shtesat mesatare 140 Euro në muaj.

SHTESAT PËRGJATË VITEVE SIPAS POZITAVE - UNIVERSITETI I GJAKOVËS



Në këtë universitet, rektori dhe një prorektore i kanë shtesat më të larta se rroga bazë.

*Fondi për shkencë

Sipas UGJFA-së, ky fond mbulohet nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve si dhe nga ajo e subvencioneve dhe transfereve, gjatë vitit 2020 janë shpenzuar 29 mijë e 70 Euro specifikisht për mbështetje në publikime dhe kërkim shkencor apo projekte mirëpo gjithsej janë shpenzuar 98 mijë e 670 Euro ndërkohë që për vitin 2021 janë planifikuar 100 mijë Euro.

Gjithashtu nga kategoria subvencione dhe transfere, UGJFA kishte ndarë 7 mijë e 800 Euro pagesa për punën praktike të studentëve.

Për krahasim, gjatë vitit 2019 ishin shpenzuar gjithsej 31 mijë e 526 Euro, ndërkohë që për vitin 2020, ishin planifikuar të shpenzohen 40 mijë Euro.



Të dhënat e detajuara sipas deklarimeve të pasurisë të vitit 2021, me shumatat që paraqesin të ardhurat vjetore të pjesëtuar për 12 muaj mund t'i gjeni në **aneksin numër 4.**

		2019	2020	2021
Mesatarja e të ardhurave mujore	Këshilli Drejtues	1437 €	1707 €	1,724 €
	Rektorati	2346 €	2092 €	2,401 €
	Dekanët	2149 €	2224 €	2,233 €
	Prodekanët	N/A	1278 €	1,755 €
Mesatarja e shtesave	Këshilli Drejtues	533 €	551 €	522 €
	Rektorati	1359 €	882 €	1,167 €
	Dekanët	1454 €	892 €	899 €
	Prodekanët	N/A	140 €	573 €
Minimumi dhe maksimumi i të ardhurave mujore	Këshilli Drejtues	1240 €, 1780 €	1181 €, 2135 €	1,239 €, 2,083 €
	Rektorati	2195 €, 2636 €	1583 €, 2610 €	2,134 €, 2,603 €
	Dekanët	2105 €, 2787 €	2165 €, 2330 €	2,118 €,
	Prodekanët	N/A	1225 €, 1330 €	1,182 €, 1,182 €
Minimumi dhe maksimumi i shtesave	Këshilli Drejtues	294 €, 871 €	408 €, 851 €	397 €, 748 €
	Rektorati	1066 €, 1727 €	300 €, 1473 €	800 €, 1,420 €
	Dekanët	962 €, 1878 €	746 €, 1047 €	784 €, 1,128 €
	Prodekanët	N/A	88 €, 193 €	498 €, 647 €



Sipas Raportit Vjetor të Buxhetit për vitin 2020, UGJFA kishte ndarë gjithsej **61 mijë e 800 Euro** bursa për 103 studentë në shumën prej **600 Euro**.

*Bursa për studentë

Sipas Raportit Vjetor të Buxhetit për vitin 2020⁵³, UGJFA kishte ndarë gjithsej 61 mijë e 800 Euro bursa për 103 studentë në shumën prej 600 Euro.

Për krahasim, gjatë vitit akademik 2019/2020⁵⁴, për 80 studentë⁵⁵ ishin ndarë bursa me shumën prej 800 Euro për 10 muaj të vitit akademik, pra gjithsej ishin shpenzuar 64 mijë Euro. Derisa për vitin akademik 2020/21 ishin planifikuar 65 mijë Euro.

*Investimet kryesore kapitale

Në këtë kategori gjatë vitit 2020,⁵⁶ janë shpenzuar 97 mijë e 864 Euro për rregullimin dhe ndarjen e disa zyrave në Rektorat dhe në njësitë akademike, furnizimin me pajisje të ndryshme laboratorike në Fakultetin e Mjekësisë, rregullimin e parkingut në Fakultetin e Edukimit dhe në Fakultetin e Filologjisë, furnizimin me pajisje për kompletimin e dhomës së serverëve në Rektorat dhe furnizimin me pajisje për Kabinetin Multimedia në Fakultetin e Filologjisë. Ndërkohë që për vitin 2021, janë planifikuar 400 mijë Euro.

Për krahasim, gjatë vitit 2019 sipas këtij universiteti, investimet kapitale nuk ishin të mundura për shkak të ndërrimit të titullarit të pronave të ish-kazermave ushtarake dhe vendimit të qeverisë për realizimin e projektit të kampusit universitar.

*Sigurimi fizik i objekteve

Sipas Raportit Vjetor të Buxhetit për vitin 2020⁵⁷, UGJFA kishte shpenzuar gjithsej 66 mijë e 381 Euro për këtë kategori, ndërkohë që ka planifikuar të shpenzojë 80 mijë Euro përgjatë vitit 2021.

53 Raport Vjetor i Buxhetit të UGJFA-së për vitin 2020, fq.7, linku: <https://uni-gjk.org/upload/dokumentet/1621512190-Vendim%2005-51.Miratohet%20Raporti%20i%20Buxhetit%20p%C3%ABr%20vitin%202020.p%C3%ABriudha%20janar-dhjetor.pdf>

54 Vendimi i Këshillit Drejtues të UGJFA-së për ndarjen e bursave për vitin akademik 2019/20, 2019, linku: <https://uni-gjk.org/upload/dokumentet/1570707522-IMG.pdf>

55 Lista e bursistëve të UGJFA-së për vitin akademik 2019/20, 2019, linku: https://uni-gjk.org/upload/dokumentet/1573050778-SKM_C55819110616550.pdf

56 Raport Vjetor i Buxhetit të UGJFA-së për vitin 2020, fq.15, linku: <https://uni-gjk.org/upload/dokumentet/1621512190-Vendim%2005-51.Miratohet%20Raporti%20i%20Buxhetit%20p%C3%ABr%20vitin%202020.p%C3%ABriudha%20janar-dhjetor.pdf>

57 Raport Vjetor i Buxhetit të UGJFA-së për vitin 2020, fq.11, linku: <https://uni-gjk.org/upload/dokumentet/1621512190-Vendim%2005-51.Miratohet%20Raporti%20i%20Buxhetit%20p%C3%ABr%20vitin%202020.p%C3%ABriudha%20janar-dhjetor.pdf>

Për krahasim, shpenzimet e paguara për këtë kategori për vitin 2019 kishin arritur shumën prej 58 mijë e 302 Euro.

*Shpenzimet gjyqësore

Gjatë vitit 2020, Universiteti i Gjakovës ka deklaruar se nuk ka shpenzime në këtë kategori. Ndërkaq për krahasim, sipas UGJFA-së në vitin 2019 kishin deponuar dy ankesa në Gjykatën Themelore të Gjakovës dhe i kishin shpenzuar 85 Euro. Ndërkohë që kanë sqaruar se gjatë vitit 2019, kanë paguar edhe për një çështje kontestimore për kompensimin e të ardhurave personale, të cilën e kanë trashëguar nga viti akademik 2015-2016, për të cilën kanë shpenzuar gjithsej 2 mijë e 307 Euro, si pasojë e aktgjykimit të formës së prerë nga gjykata në fjalë.

Të gjetura nga Auditori

Në Raportin e Auditimit për MASHTI-në për vitin 2020⁵⁸, nuk ka ndonjë të gjetur për këtë universitet në të cilën specifikohet se ka pasur parregullsi në procedura apo pagesa të ndryshme.



Sipas Raportit Vjetor të Buxhetit për vitin 2020, UGJFA kishte shpenzuar gjithsej **66 mijë e 381 Euro** për këtë kategori, ndërkohë që ka planifikuar të shpenzojë **80 mijë Euro** përgjatë vitit 2021.

⁵⁸ Raporti i Auditimit për pasqyrat financiar të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për vitin 2020, linku: https://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2021/07/RaportiAuditimit_MASHTI_2020_Shqip.pdf



UNIVERSITETI I MITROVICËS

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës⁵⁹, Universiteti i Mitrovicës (UMIB), ka gjithsej 103 punonjës akademik të rregullt, prej tyre 30 gra dhe 73 burra, si dhe 32 të angazhuar, prej tyre 11 gra dhe 21 burra.

Universiteti i Mitrovicës për vitin 2020, në nivelin Bachelor ka gjithsej 2 mijë e 33 studentë, në nivelin Master ka gjithsej 156 studentë, ndërsa nivelin e doktoratës nuk e ka.

Numri i studentëve në Universitetin e Mitrovicës

	BA			MA			PhD		
			Gjithsej			Gjithsej			Gjithsej
2019/20	1,126	534	1,660	72	80	152	-	-	-
2020/21	1,316	717	2,033	73	83	156	-	-	-

Raporti student-mësimdhënës në Universitetin e Mitrovicës për këtë periudhë del të jetë 21:1.

⁵⁹ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e arsimit në Kosovë 2020/21, fq. 84, linku: <https://ask.rks-gov.net/media/6072/statistikat-e-arsimit-20202021.pdf>

Numri i të diplomuarve në Universitetin e Mitrovicës

	BA			MA		
			Gjithsej			Gjithsej
2018/19	140	96	236	18	28	47
2019/20	173	83	256	19	13	32

Analiza e shpenzimeve

Nga thesari i buxhetit të Kosovës, për Universitetin e Mitrovicës, ishin ndarë gjithsej 4 milionë e 374 mijë e 301 Euro për vitin 2020⁶⁰, ndërsa ishin shpenzuar 4 milionë e 96 mijë e 584 Euro. Kurse për vitin 2021, është ndarë apo planifikuar të shpenzohet shuma prej 4 milionë e 246 mijë e 584 Euro.

Për krahasim, në vitin 2019 nga buxheti i Kosovës⁶¹ ishin shpenzuar gjithsej 4 milionë e 674 mijë e 308 Euro.

67% e buxhetit të ndarë për këtë universitet për vitin 2020, është shpenzuar për paga dhe mëditje të stafit akademik, me 2 milionë e 765 mijë e 45 Euro, të parapara për 199 të punësuar. Krahasuar me vitin 2019, kur për paga dhe mëditje ishte shpenzuar shuma prej 2 milionë e 642 mijë e 769 Euro. Ndërkaq për vitin 2021, janë ndarë 2 milionë e 765 mijë e 45 Euro.

Për mallra dhe shërbime, UMIB kishte shpenzuar 366 mijë e 339 Euro gjatë vitit 2020, ndërkohë që gjatë vitit 2019, ishte shpenzuar shuma prej 866 mijë e 339 Euro. Kurse për vitin 2021, është ndarë shuma prej 450 mijë Euro⁶².

60 Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, linku: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/23991BEA-4CD9-40B3-94D3-EA192C572464.pdf>

61 Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, linku: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/4CEFBA4C-4397-4901-AB93-2AA37F43A9F7.pdf>

62 Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, linku: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/5EA509E4-2933-4524-BD0F-5466A661486F.pdf>



LINJA BUXHETORE PËR UNIVERSITETIN E MITROVICËS 2019, 2020 DHE 2021

Pagat dhe mëditjet	2019	2,642,769	57%
	2020	2,765,045	67%
	2021	2,765,045	73%
Mallrat dhe shërbimet	2019	866,339	19%
	2020	366,339	9%
	2021	450,000	12%
Shpenzimet komunale	2019	215,000	5%
	2020	215,200	5%
	2021	215,200	6%
Subvencionet dhe transferet	2019	100,000	2%
	2020	100,000	2%
	2021	100,000	3%
Shpenzimet kapitale	2019	850,000	18%
	2020	650,000	16%
	2021	240,000	6%
Total Shpenzimet	2019	4,674,308	100%
	2020	4,096,584	
	2021	3,770,245	

Për shpenzime komunale gjatë vitit 2020, janë shpenzuar 215 mijë Euro, ndërkaq gjatë vitit 2019, ishte shpenzuar shuma e njëjtë, si dhe është planifikuar e njëjta për vitin 2021. Shuma e shpenzuar dhe e ndarë për subvencione dhe transfere në UMIB, përgjatë viteve 2021, 2020 dhe 2019 nuk ka ndryshuar, pra është nga 100 mijë Euro.

Buxheti për shpenzime kapitale për vitin 2020 ishte 650 mijë Euro, për krahasim me vitin 2019 kur ishin shpenzuar gjithsej 850 mijë Euro. Kurse për vitin 2021, janë ndarë 240 mijë Euro.

Shumës së përgjithshme të buxhetit të ndarë nga Qeveria e Kosovës, UMIB i kishte shtuar edhe 114 mijë e 661 Euro nga të hyrat vetanake, sipas ligjit mbi ndarjet buxhetore për vitin 2020.

Shpenzimet për studentë në vitin 2021 janë 2 mijë e 144 Euro për kokë studenti. Për krahasim, vitin e kaluar kanë qenë 2 mijë e 963 Euro.

Të ardhurat personale të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Mitrovicës

Pagat e profesorëve dhe shtesat në Universitetin e Mitrovicës janë të rregulluara përmes Rregullores për të ardhura personale në Universitetin e Mitrovicës, e miratuar më 06.11.2015.⁶³

⁶³ Rregullorja për të ardhura personale në Universitetin e Mitrovicës. 06.11.2015. Link: <https://www.umib.net/wp-content/uploads/2019/09/Teks-tin-e-spastruar-te-Rregullores-per-te-ardhurat-personale-ne-UMIB.pdf>

Neni 5 i kësaj rregullore, përcakton kompensimin e personelit akademik me normë të plotë, sipas kësaj tablele:

Titulli	Orë në javë	Paga mujore
Profesorët e rregullt	 6	1429.54 Euro
Profesorët e asocuar	 6	1283.34 Euro
Profesorët asistent	 6	1137.14 Euro
Profesorët e shkollave të larta	 6	1137.14 Euro
Ligjëruesit	 6	990.00 Euro
Lektorët	 10	844.73 Euro
Asistentët	 10	772.50 Euro
Asistent i ri	 10	698.75 Euro

Tabela 1. Pagat bazë të personelit akademik në Universitetin e Mitrovicës

Po ashtu, përtej pagës bazë, stafi akademik i cili ushtron detyra menaxheriale në kuadër të Universitetit të Mitrovicës, kompensohet sipas kësaj tablele:

Pozita	Shtesa
Rektor	500 Euro
Prorektor	450 Euro
Dekan	350 Euro
Prodekan	250 Euro

Tabela 2. Shtesat për pozita menaxheriale në Universitetin e Mitrovicës

Personeli akademik në Universitet të Mitrovicës ka të drejtë të angazhohet në orë shtesë (mbi-norma) deri në 5 orë në javë (profesorët) dhe deri në 8 orë në javë (lektorët, asistentët). Këto orë shtesë kompensohen sipas kësaj tablele:

Titulli	Shtesa
Profesorë (të rregullt, të asocuar dhe asistent)	25 Euro
Ligjërues, lektor, asistent	13 Euro

Tabela 3. Kompensimet e mbi-normës

Personeli akademik po ashtu kompensohet për mentorimin e temave të diplomës si dhe për pjesëmarrjen në komisione të vlerësimit të temës së diplomës, në nivelet BA, MA dhe PhD.


Komisioni	BA	MA	PHD
Mentori	20 Euro	250 Euro	1000 Euro
Kryetari i komisionit	n/a	90 Euro	300 Euro
Anëtar i komisionit	10 Euro	80 Euro	250 Euro

Tabela 4. Kompensimet e mentorimeve të temave të diplomës

Analiza e të dhënave nga deklaratimet e pasurisë

Në analizën e deklaratave të pasurisë për Universitetin e Mitrovicës janë përfshirë anëtarët e Këshillit Drejtues (vetëm anëtarët me titull akademik), rektori, prorektorët, dekanët dhe prodekanët.


SHTESAT E STAFIT MENAXHERIAL NË UNIVERSITETIN E MITROVICËS NDËR VITE



Në përgjithësi të ardhurat mujore të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Mitrovicës kanë pasur rënie graduale në dy vitet e kaluara mirëpo këtë vit janë rritur. Derisa në vitin 2019 mesatarja e të ardhurave mujore ishte 1 mijë e 940 Euro, në vitin 2020 kjo shumë është zbritur në 1 mijë e 872 Euro, ndërsa në vitin 2021 është rritur prapë në 1 mijë e 913 Euro.

Ndërkaq shtesat mujore gjithashtu kanë pasur ndryshimet e ngjashme, nga 779 Euro sa ishin në vitin 2019, në 651 Euro gjatë vitit 2020 dhe tani mesatarja është rritur në 693 Euro.

TË ARDHURAT MUJORE PËRGJATË VITEVE SIPAS POZITAVE - UNIVERSITETI I MITROVICËS



Në analizën e deklarimeve të pasurisë për Universitetin e Mitrovicës janë përfshirë anëtarët e Këshillit Drejtues (vetëm anëtarët me titull akademik), rektori, prorektorët, dekanët dhe prodekanët.

Anëtarët e Këshillit Drejtues me titull akademik mesatarisht paguhen 1746 Euro në muaj nga buxheti i Universitetit, ku mesatarisht ata marrin 653 Euro në muaj në shtesa. Këto shtesa përbëjnë rreth 37% të rrogës së tyre mujore. Këto shifra tregojnë për një rënie të shtesave krahasuar me deklarimet e pasurisë të vitit 2020 ku të ardhurat mesatare ishin 1915 Euro në muaj dhe shtesat mesatare 869 Euro në muaj. Megjithatë, në deklarimet e pasurisë të vitit 2019, të ardhurat mesatare mujore ishin më të ulëta me 1745 Euro në muaj, prej tyre mesatarisht 652 Euro shtesa.


Anëtarët e Rektoratit mesatarisht paguhen 2023 Euro në muaj nga buxheti i universitetit, ku 739 Euro janë shtesa. Këto shtesa përbëjnë rreth 37% të rrogës së tyre mujore. Ka rritje nga deklarimet e pasurisë të vitit 2020 ku të ardhurat mesatare ishin 1964 Euro dhe shtesat

mesatare 645 Euro në muaj. Të ardhura të larta kishte edhe në deklarinimet e pasurisë të vitit 2019, me mesatarisht 2398 Euro në muaj, prej tyre 1079 Euro shtesa.

Dekanët e fakulteteve mesatarisht paguhën 2101 Euro në muaj nga buxheti i universitetit, ku 794 Euro janë shtesa. Këto shtesa përbëjnë rreth 38% të rrogës së tyre mujore. Këto shifra tregojnë për një rritje të shtesave krahasuar me deklarinimet e pasurisë së vitit 2020 ku të ardhurat mesatare ishin 2024 Euro në muaj dhe shtesat mesatare 692 Euro në muaj. Në 2019 ku mesatarja e të ardhurave ishte 1986 Euro në muaj dhe e shtesave 812 Euro në muaj.

Prodekanët e fakulteteve mesatarisht paguhën 1821 Euro në muaj nga buxheti i universitetit, ku 620 Euro janë shtesa. Këto shtesa përbëjnë rreth 34% të rrogës së tyre mujore. Ka rritje të shtesave krahasuar me deklarinimet e pasurisë të vitit 2020 ku të ardhurat mesatare ishin 1664 Euro në muaj dhe shtesat mesatare 496 Euro në muaj. Në deklarinimet e pasurisë të vitit 2019 të ardhurat mesatare mujore ishin 1710 Euro, prej të cilave 609 Euro ishin shtesa.

SHTESAT PËRGJATË VITEVE SIPAS POZITAVE - UNIVERSITETI I MITROVICËS



Një anëtare e Këshillit Drejtues dhe një prodekan i kanë shtesat më të larta sesa rrogat bazë.

*Fondi për shkencë

Në Raportin e të Hyrave dhe Shpenzimeve për vitin 2020⁶⁴, UMIB thuhet se ka shpenzuar vetëm 552 Euro për publikimin e punimeve shkencore. Ndërkaq sa i përket planifikimit për vitin 2021, nuk ka të dhëna konkrete për shumën që është synuar që të shpenzohet për këtë kategori.

Për krahasim, në vitin 2019 nuk kishte informata publike përmes të cilave mund të bëhej e ditur shuma e ndarë për këtë kategori apo planifikimi për vitin 2020.

*Bursa për studentë

Sipas Raportit të të Hyrave dhe Shpenzimeve për vitin akademik 2020/2021, UMIB ka shpenzuar gjithsej 45 mijë e 820 Euro për ndarjen e bursave për 58 studentë në shumën prej 790 Euro. Ndërkaq sa i përket planifikimit për vitin 2021⁶⁵, UMIB ka planifikuar 100 mijë Euro për shpenzim kryesisht ndaj bursave për studentët e dalluar.

64 Raport i të Hyrave dhe Shpenzimeve për vitin fiskal 2020, fq.18, linku: <https://www.umib.net/wp-content/uploads/2021/02/RAPORT-I-TE-HYRAVE-DHE-SHPENZIMEVE-2020.pdf>

65 Buxheti për vitin 2021-vlerësimet për vitet 2022/2023, Fq.9, linku: <https://www.umib.net/wp-content/uploads/2021/04/Buxheti-2021.pdf>



Të dhënat e detajuara sipas deklarimeve të pasurisë të vitit 2021, me shumat që paraqesin të ardhurat vjetore të pjesëtuar për 12 muaj mund t'i gjeni në **aneksin numër 5.**

		2019	2020	2021
Mesatarja e të ardhurave mujore	Këshilli Drejtues	1745 €	1915 €	1,746 €
	Rektorati	2398 €	1964 €	2,023 €
	Dekanët	1986 €	2024 €	2,101 €
	Prodekanët	1710 €	1664 €	1,821 €
Mesatarja e shtesave	Këshilli Drejtues	652 €	869 €	653 €
	Rektorati	1079 €	645 €	739 €
	Dekanët	812 €	692 €	794 €
	Prodekanët	609 €	496 €	620 €
Minimumi dhe maksimumi i të ardhurave mujore	Këshilli Drejtues	1505 €, 2250 €	1684 €, 2476 €	1,560 €, 1,905 €
	Rektorati	2105 €, 2822 €	1721 €, 2261 €	1,889 €, 2,224 €
	Dekanët	1647 €, 2343 €	1778 €, 2285 €	1,918 €, 2,285 €
	Prodekanët	1530 €, 1922 €	1140 €, 1849 €	773 €, 1,430 €
Minimumi dhe maksimumi i shtesave	Këshilli Drejtues	506 €, 890 €	547 €, 1193 €	368 €, 788 €
